



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 20, Korrik 2016

ISSN 2225-2959



DREJT 0%



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

FORUMI 4-t I SIGURISË SË INFORMACIONIT

Tetor 2016

- Siguria në Bankingun Dixhital
- Si kanë evoluar rreziqet në teknologji, dhe si mund të mbrohemi nga sulmet Ransomware
- Incidentet, mbrojtja dhe procedurat e reagimit në kushtet e rreziqeve të reja; Praktikrat më të mira dhe evitimi i vështirësive

ANËTARËT E AAB



Përmbajtja



DREJT 0%

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org;
www.aab.al

Bankieri

Nr.20, Korrik 2016
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Editorial

Norma bazë e interesit 0%, ose momenti i të vërtetës për ekonominë, sipërmarrjen dhe politikëbërësit shqiptarë!

Prof.Asoc.Dr. Elvin MEKA

Tema e Ditës

Pse nuk kemi mjaftueshëm rritje ekonomike, pavarësisht normave të ulëta të interesit

Kaan PEKIN

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë Efektiviteti dhe sfidat e saj

Erald THEMELI, MSc

Politika monetare në Shqipëri nën një pikëpyetje të madhe
Aurora SULÇE

Intervistë

Dr. Spiro BRUMBULLI Sekretari i ri i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB

Dr. Spiro BRUMBULLI

Sistemi Bankar

Unifikimi/Standardizimi i Urdhërpagesës Rruga për rritjen e produktivitetit dhe lehtësimin e procesit

Najada XHAXHA

Produktet e reja në sistemin bankar shqiptar¹

Fatih KARLI

Siguria në bankingun digjital

Anila TOLLKUÇI

Forumi i Ekspertëve

Roli dhe sfidat e AMF-së në kuadër të menaxhimit të rrezikut e lehtësimit monetar

Enkeleda SHEHI

Një perspektivë e biznesit mbi përfitimet e marrëveshjes për lehtësimin e tregtisë së OBT-së

ICC Albania

Këndi i Ekonomistit

"Lehtësimi sasior" dhe deflacioni Pikëpyetjet e Bankave Qendrore

Prof.Dr. Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria Sociale

Veprimtaritë e Bankave

Auditori Financiar

Paratë nga helikopteri

Prof. Asoc. Dr. Arbi AGALLIU

AAB Aktivitete

Bankingu Digjital në Shqipëri

AAB Trajnime

REDAKSIA:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katroshti)

Bashkëpunëtore

Andis Rado

Fotograf

Design & Layout: FCB Afirma

Printed by: Gent-grafik

BORDI EDITORIAL:

Christian CANACARIS

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank Shqipëri

Gazmend KADRIU

Nënkryetar i i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank

Periklis DROUGKAS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania

Seyhan PENCABLIGIL

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Banka Kombëtare Tregtare

Frédéric BLANC

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Societe Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Fibank Shqipëri

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Adrian CIVICI

President i Universitetit European të Tiranës

Enkeleda SHEHI

Drejtoreshë Ekzekutive e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

Kredi Konsumatore Alpha Realizo

Është koha që dëshirat tuaja të bëhen të vërteta!

Kredia Konsumatore Alpha Realizo ju mundëson plotësimin e dëshirave dhe nevojave tuaja. Ajo është ideuar enkas për të gjithë ju që dëshironi të blini mobilje të reja ose pajisje elektroshtëpiake për shtëpinë tuaj apo për të mbuluar çdo nevojë tjetër të jetës tuaj të përditshme.

Aplikoni për një kredi konsumatore Alpha Realizo dhe përfitoni:

- **Këste mujore të përballueshme, duke filluar nga 6,160 Lekë**
- **Afat ripagimi deri në 7 vjet**
- **Kreditim deri në 300,000 Lekë, pa garantues**
- **Kreditim deri në 1,000,000 Lekë, pa kolateral**

Aplikoni sot në një nga degët e Alpha Bank Albania, telefononi në numrin **042 384 178** ose vizitoni www.alphabank.al për tu njohur me kushtet e ofertës.



ALPHA BANK

Gjithmonë të sigurt, gjithmonë bashkë.

042 384 174, www.alphabank.al



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Norma bazë e interesit në nivele shumë të ulëta edhe në Shqipëri nuk përbën më lajm, të paktën që nga momenti kur ajo zbriti, për herë të parë, në 2%. Gjatë 3 viteve të fundit kemi qenë dëshmitarë të uljeve të njëpasnjëshme të normës bazë të interesit nga ana e Bankës së Shqipërisë, me synimin e qartë: nxitjen e konsumit dhe uljen e prirjes për kursim të publikut, si dhe stimulimin e kreditimit të ekonomisë.

Sot në ekonominë kombëtare vihet re se kreditimi i ekonomisë, veçanërisht ai në monedhë kombëtare, po vijon thujt pa ndërprerje, pavarësisht se efekti i tij thujt neutralizohet nga ripagesat e huave të mëparshme, duke bërë që portofoli ekzistues i huave të qëndrojë thujt i palëvizur, pa llogaritur këtu çështjen e huave me probleme. Asnjëherë më parë kosto e huas nuk ka qenë kaq e ulët, e ndikuar kjo thelbësisht nga uljet e shpeshta të normës bazë të interesit nga Banka e Shqipërisë, por problemi nuk është ky; problemi mbetet te struktura e huamarrjes, që fatkeqësisht po vrapon drejt asaj afatshkurtër, ndërkohë që rrallohet portofoli i huave afatgjata për investime. Gjithashtu, uljet e njëpasnjëshme historike të normës

Norma bazë e interesit 0%, ose momenti i të vërtetës për ekonominë, sipërmarrjen dhe politikëbërësit shqiptarë!



Ky nivel do të jetë momenti i të vërtetës, ku grupet e interesit deri tani spektatorë, do të kuptojnë se mekanizmi i normës së interesit e ka kryer plotësisht funksionin e tij, mandati ligjor dhe teknik i Bankës së Shqipërisë nuk mund të ndihmojë më shumë për stimulimin e huamarrjes, konsumit, investimeve e sipërmarrjes dhe se sfida e stimulimit të rritjes ekonomike del përfundimisht nga dera e Bankës së Shqipërisë dhe kalon në territorin e "spektatorëve".



bazë të interesit nuk po arrijnë të nxisin konsumin dhe investimet prodhuese në ekonomi, dy elementë thelbësorë të PBB-së, e kjo për një mori arsyesh, që lidhen kryesisht me strukturën dhe modelin e derisotëm ekonomik të vendit, klimën e biznesit dhe stadin fillestar, ose problematik të reformave strukturore në Shqipëri. Sipërmarrja shqiptare po krijon me shumë vështirësi vlerë të shtuar e po sipërmerr më pak rrezik, ndërkohë që familjet shqiptare po konsumojnë gjithnjë e më uniformisht në vite, duke u përgatitur çdo vit për "ditët me shi" të së ardhmes.

Në kushte të tilla, duket se sipërmarrja, nuk po ngrihet në lartësinë e emrit që ka; pra nuk po kryen sipërmarrje, që nënkupton se nuk po gjeneron punësim shtesë, pra qarkullim monetar shtesë dhe konsum shtesë. Nga ana tjetër, familjet dhe institucionet po garojnë për të blerë sa më shumë letra afatgjata me vlerë të qeverisë, çka ul edhe më shumë normën reale të interesit në ekonomi, duke "konsumuar" me shpejtësi të madhe alternativën thujt të fundit të sigurimit të një kthimi racional nga investimi, pa sipërmarrë rrezik thelbësor përsipër.

Nëse kjo panoramë sjelljeje ekonomike, që kopjohet thujt identikisht çdo vit, do të vazhdojë të ripërsërisë vetveten,

atëherë të gjithë grupet e interesit do vijojnë të presin si spektatorë, derisa Banka e Shqipërisë të harxhojë të gjithë "municionin" e saj edhe me 4 – 5 ulje të tjera "historike", duke ecur e sigurt dhe shpejt drejt normës bazë të interesit prej 0%. Ky nivel do të jetë momenti i të vërtetës, ku grupet e interesit deri tani spektatorë, do të kuptojnë se mekanizmi i normës së interesit e ka kryer plotësisht funksionin e tij, mandati ligjor dhe teknik i Bankës së Shqipërisë nuk mund të ndihmojë më shumë për stimulimin e huadhënies, konsumit, investimeve e sipërmarrjes dhe se sfida e stimulimit të rritjes ekonomike del përfundimisht nga dera e Bankës së Shqipërisë dhe kalon në territorin e "spektatorëve". Deri në mbërritjen e momentit të së vërtetës për ekonominë, sipërmarrjen dhe politikëbërësit shqiptarë, pra deri sa norma bazë e interesit të arrijë 0%, të gjithë duhet të kuptojnë më së miri dhe të jetësojnë filozofinë e fjalisë ikonike të Presidentit Ruzvelt në fjalimin e tij përurues si president i SHBA-së në vitin 1933: "...e vetmja gjë nga e cila duhet të kemi frikë është...vet frika...!"

¹ Zv.Rektor për Procesin Akademik, UET



Kaan PEKIN

Drejtor i Grupit të Thesarit &
Institucioneve Financiare
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Banka e Shqipërisë uli dy herë këtë vit me 25 pikë bazë normën bazë të interesit (normën e interesit të Repo-ve një-javore), respektivisht në mes të prillit dhe në fillim të muajit maj, duke synuar rritjen e stimullit monetar në ekonomi. Norma bazë ishte 1.75% në nëntor '15, por ajo zbriti në 1.25% pas këtyre dy uljeve të fundit. Qartësisht politika monetare e Bankës së Shqipërisë po synon të mbështesë gjithnjë e më fort rritjen e mëtejshme e huadhënies, investimet private dhe konsumin në ekonomi. Gjithsesi, a mund të stimulojnë normat e ulëta të interesit rritjen e huadhënies dhe zgjerimin ekonomik? A mund të ndikojnë uljet e normës bazë të interesit në procesin e vendimmarrjes të bankave tregtare dhe çmimin e huadhënies së tyre dhe a transformohet kjo ulje në zgjerim të portofolit të huas? Për t'iu përgjigjur pyetjeve të

Pse nuk kemi mjaftueshëm rritje ekonomike, pavarësisht normave të ulëta të interesit



“Mekanizmi i Transmetimit Monetar”, që kontrollon nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet pompimit të parave, ose uljes së normës bazë të interesit, funksionon vetëm për huat në Lek. Natyrisht, Banka e Shqipërisë nuk është dhe nuk mund të jetë autoriteti monetar për monedhat e huaja.



mësipërme na nevojitet të kuptojmë se pse normat e interesit janë vazhdimisht kaq të ulëta, jo vetëm në Shqipëri, por dhe globalisht. Për një analizë më të mirë, do të përpiqem t'i paraqes thjesht argumentet, duke iu referuar dy fakteve aktuale, të cilët janë jashtë kontrollit të Bankës së Shqipërisë.

Së pari, shumica e njerëzve që marrin hua për qëllime të ndryshme, besojnë se po e marrin atë nga banka, apo ndonjë union krediti. Me fjalë të thjeshta, marrja e një huaje në bankë, në të vërtetë nuk është gjë tjetër veçse marrja e një huaje nga një anëtar tjetër i shoqërisë, përmes shërbimeve të bankës. Individit, apo biznesit, që ka hapur një llogari kursimi, apo një depozitë me afat pranë bankës është ofruesi i vërtetë i huas, apo i huas për strehim dhe banka është thjesht lidhja mes tyre. Banka mund të përdorë jo vetëm burimet e saj, të vëna në dispozicion nga klientët e saj të depozitave, por ajo mund t'i grupojë burimet e saj të financimit, duke i shitur këto hua te një tjetër ndërmjetës financiar, gjë kjo që i siguron përsëri fonde bankës nga individët apo bizneset.

Rrënjët e teorisë së ekonomisë gjenden në analizën e thjeshtë të

kërkesës dhe ofertës dhe çmimet përcaktohen në pikën ku oferta dhe kërkesa ndërpritin me njëra – tjetrën. Në këtë kontekst, çdo ulje e normave bazë të interesit nga bankat qendrore zakonisht synon nxitjen e konsumit dhe të kërkesës për hua, duke ndikuar mbi vendimet e kursimtarëve dhe huamarrësve, nëpërmjet çmimit më të ulët të parasë. Megjithatë, në botën e sotme ku shumica e kursimtarëve janë të shqetësuar lidhur me aftësinë për të ruajtur konsumin e tyre të ardhshëm në nivelin e sotëm, përpjekja e bankave qendrore për të ulur normat e interesit bën që kursimtarët të ulin konsumin dhe të rrisin kursimet e tyre, pavarësisht nga ulja e çmimit të parasë (normat më të ulëta të interesit). Kjo shkakton një spirale, ku normat e interesit dhe zgjerimi ekonomik qëndrojnë në nivele të ulëta në nivel global, për një periudhë të pacaktuar kohe. Ky proces shkaktohet nga një ndryshim në tolerancën që aktorët ekonomikë (si kursimtarët ashtu dhe huamarrësit) kanë ndaj rrezikut, ku kursimtarët nuk duan të konsumojnë dhe huamarrësit nuk duan të investojnë më shumë, për shkak të përkeqësimit të pritshmërive të tyre në të ardhmen.

Për sa i përket vendit tonë, Banka e Shqipërisë ka qenë shumë e suksesshme në uljen e normave të interesit. Konkretisht, yield-i mesatar për bonot e thesarit 12 mujore zbriti në nivelin 1.28% në fund të korrikut '16, krahasuar me yield-in mesatar prej 3.22% në fund të korrikut '15; që do të thotë se norma 1 vjeçare e interesit është ulur me 2.5 herë gjatë kësaj periudhe kohe. Për më tepër, obligacionet qeveritare 5 vjeçare, që konsiderohen si një tregues më i mirë për normat e huave, ranë në 3.43% në muajin maj '16, në krahasim me 6.45% që ato paguanin në maj '15. Kjo tregon një rënie prej 1.9 herë në normën e interesit të obligacioneve 5 vjeçare. Rënia e fortë në normat e interesit është gjithashtu rezultat edhe i shkëmbimit (zëvendësimit) të suksesshëm të borxhit qeveritar nga ana e Ministrisë së Financave, e cila zëvendësoi një pjesë të konsiderueshme të borxhit të brendshëm me borxhin e jashtëm, të ofruar nga FMN-ja, BB-ja dhe institucione të ngjashme me to. Rënia e ndjeshme e normave të interesit në monedhën vendase detyroi, në mënyrë të pashmangshme, sistemin bankar që të ulë normat e huave të akorduara. Megjithatë, normat e ulëta të interesit nuk janë faktorët e vetëm përcaktues për zgjerimin e huadhënies dhe konsumit, pasi faktori aktual përcaktues i rritjes së konsumit dhe huadhënies është pritshmëria e ardhshme e aktorëve ekonomikë.

Së dyti, fakti tjetër real që unë dua të parashtroj me këtë rast ka të bëjë me përbërjen e portofolit agregat të huamarrësve, sipas monedhës. Këtu unë me qëllim nuk e quaj atë portofol të bankave, pasi këtë lloj përbërje të portofolit të huave e përvijuan vendimet e huamarrësve, më shumë sesa strategjitë e huadhënies së vet bankave. Ekziston një larmi e madhe faktorësh që mund të kenë ndikuar në vendimin e huamarrësve për të zgjedhur huan në euro, në krahasim me atë në Lek, por qëllimi këtu nuk është diskutimi rreth këtyre faktorëve. Nëse kthehemi 8 vjet më

parë, në dhjetor 2008 dhe konsultojmë përbërjen e portofolit agregat të huave nga huamarrësit në Shqipëri, shohim se 72.6% e huave janë marrë në monedhë të huaj (kryesisht euro) dhe vetëm 27.4% e tyre janë marrë në Lek. Konkretisht, portofolit total i huas ishte 396,768 miliardë lekë, ndërkohë që në ai në monedhë të huaj ishte i barabartë me 288,106 miliardë lekë. Deri në fund të marsit 2016 (të dhënat e fundit të disponueshme), kjo përbërje ndryshoi në favor të huave në Lek, por ende huaja në monedhë të huaj tejkalon atë në Lek, me rreth 60.6% të totalit të



Normat e interesit për monedhën euro janë gjithashtu në nivelin e tyre më të ulët historik dhe nominalisht janë më të ulëta se normat e interesit në Lek. Gjithsesi, ne nuk kemi qenë dëshmitarë të ndonjë zgjerimi të huas, apo rritje të konsumit. Sjellja kundërshtuese ndaj rrezikut e kursimtarëve dhe prirja për të kursyer më shumë është ajo çka e frenon kërkesën për hua, si për investime ashtu dhe për konsum. Gjithashtu, jo-efikasiteti i normave të ulëta të interesit në Shqipëri, mund të shpjegohet edhe me mungesën (relative) të huamarrësve të kualifikuar.



huave. Portofoli total i huas, i shprehur në Lek është aktualisht 589,062 miliardë lekë, ndërsa ajo në monedhë të huaj është 356,983 miliardë lekë.

Fakti këtu është se “Mekanizmi i Transmetimit Monetar”, që kontrollohet nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet pompimit të parave, ose uljes së normës bazë të interesit, funksionon vetëm për huat në Lek. Natyrisht, Banka e Shqipërisë nuk është dhe nuk

mund të jetë autoriteti monetar për monedhat e huaja, si p.sh.: euro dhe ajo nuk ka fuqi të kontrollojë plotësisht mekanizmin e transmetimit monetar, nëse pjesa më e madhe e huave në Shqipëri nuk merren në Lek. Për më tepër, për Shqipërinë unë edhe guxoj të pohoj se është Banka Qendrore Europiane (ECB) dhe jo Banka e Shqipërisë, ajo që ka më shumë fuqi në mekanizmin e transmetimit monetar, pasi pjesa më e madhe e huave në vendin tonë janë marrë në euro.

Megjithatë, normat e interesit për monedhën euro janë gjithashtu në nivelin e tyre më të ulët historik dhe nominalisht janë më të ulëta se normat e interesit në Lek. Gjithsesi, ne nuk kemi qenë dëshmitarë të ndonjë zgjerimi të huas, apo rritje të konsumit. Këtu unë i referohem përsëri faktit të parë të shpjeguar më lart; sjellja kundërshtuese ndaj rrezikut e kursimtarëve dhe prirja për të kursyer më shumë është ajo çka e frenon kërkesën për hua, si për investime ashtu dhe për konsum. E fundit por jo më pak e rëndësishme, jo-efikasiteti i normave të ulëta të interesit në Shqipëri, mund të shpjegohet edhe me mungesën (relative) të huamarrësve të kualifikuar.

Perspektiva e përkeqësuar për të ardhmen në nivel global përbën një pengesë, e cila nuk mund të eliminohet as nga Banka e Shqipërisë, e as nga Ministria e Financave/Qeveria. Megjithëse normat e interesit, si në euro ashtu dhe ato në Lek, janë në minimumet e tyre historike, nuk po konstatohet ende rritja e dëshiruar në zgjerimin huadhënies, konsumit dhe veprimtarisë ekonomike. Rimëkëmbja e huadhënies bankare (mekanizmi i financimit midis kursimtarëve dhe huamarrësve nëpërmjet shërbimeve të bankave) mbetet një parakusht për një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë, e kjo është një ndër objektivat afatmesme të Bankës së Shqipërisë, por periudha e zgjatur e një mjedisi me norma të ulëta interesi dhe përkeqësimi i pritshmërive të ardhshme të aktorëve ekonomikë janë rreziku më i madh për objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë.



Erald THEMELI, MSc

Drejtore, Departamenti i Politikës Monetare
BANKA E SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë ndërmori dy ulje të njëpasnjëshme të normës bazë të interesi në muajt prill dhe maj 2016. Ky lehtësim i politikës monetare e sollti normën bazë të interesit në minimumin e ri historik prej 1.25%. Ai u shoqërua me komente të shumta, si në median e gjerë ashtu dhe në atë profesionale, lidhur me dobinë apo efektivitetin e pritur të tij. Sigurisht, për lëvizje të tilla gjykohet me vlerë nga pikëpamja profesionale, të parashtrohet edhe këndvështrimi i Bankës së Shqipërisë mbi objektivat, arritjet dhe sfidat e politikës monetare.

1. Politika monetare në kontekstin ekonomik e financiar shqiptar

Ndonëse u prek disi me vonesë, ekonomia shqiptare nuk i shpëtoi ndikimit të krizës botërore. Ky zhvillim është natyrisht i kuptueshëm për një ekonomi të vogël e të hapur, me një shkallë të lartë integrimi financiar

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Efektiviteti dhe sfidat e saj

Për sa kohë inflacioni dhe pritjet inflacioniste nuk janë ankoruar qëndrueshëm në objektiv, sfida e madhore e politikës monetare mbetet e hapur. Megjithëse përballemi me trysni të dobëta inflacioniste, si në mjedisin e brendshëm dhe në atë të jashtëm, Banka e Shqipërisë është në gjendje ta fitojë këtë sfidë.

me Eurozonën. Efektet e krizës u transmetuan fillimisht nëpërmjet reduktimit të shkëmbimeve tregtare dhe financiare dhe u plotësuan më tej me rritjen e pasigurisë dhe zgjerimin e primeve të rrezikut, në tregjet e brendshme financiare. Për rrjedhojë, ritmi i rritjes ekonomike u përgjysmua, nga një mesatare rreth nivelit 6% në pesë vitet para krizës, në një mesatare



Objektivi madhor i politikës monetare ka qenë dhe të mbetet ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Për sa kohë inflacioni dhe pritjet inflacioniste nuk janë ankoruar qëndrueshëm në objektiv, sfida e madhore e politikës monetare mbetet e hapur. Megjithëse përballemi me trysni të dobëta inflacioniste, si në mjedisin e brendshëm dhe në atë të jashtëm, Banka e Shqipërisë është në gjendje ta fitojë këtë sfidë.

prej 3% për periudhën pasuese. Ngadalësimi ekonomik u pasqyrua në rritjen e papunësisë dhe në rënien e inflacionit. Ai krijoi vështirësi financiare për sektorin privat, çka ndikoi në rritjen e huave me probleme në sistemin bankar. Këto zhvillime diktuan një reagim të vendosur të politikës monetare. Politika jonë monetare u orientua drejt një cikli lehtësues, intensiteti i të cilit ka ardhur në forcim progresiv. Përtej goditjes fillestare, ky lehtësim u diktua dhe nga kalimi i politikës fiskale në kahun konsolidues dhe – së fundmi – nga dobësimi i trysnive inflacioniste në tregjet ndërkombëtare.

Banka e Shqipërisë kishte arsye të shëndosha për ndjekjen e një politike të tillë:

- Mandati jonë ligjor është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, e përcaktuar si një nivel inflacioni prej 3%. Rënia e inflacionit poshtë objektivit ishte, ndër të tjera, një simptomë e kërkesës së pamjaftueshme agregate. Teoria moderne ekonomike e sheh politikën monetare si një instrument për administrimin e kërkesës agregate, pra si një instrument i dizenuar posaçërisht për të reaguar



ndaj goditjeve të kërkesës.

- Nivelet e ulëta të inflacionit, nëse zgjaten në kohë, mund të shkaktojnë rënie të pritjeve inflacioniste. Kjo mund të shkaktojë lindjen e rretheve vicioze, ku pritjet e ulëta inflacioniste tkurrin kërkesën agregate, reduktojnë inflacionin dhe gjenerojnë rënie të mëtejshme të pritjeve inflacioniste, duke e nisur rishitazi ciklin.

- Zgjerimi i pasigurisë rriti primet e rrezikut dhe kërkesën për likuiditet në tregjet financiare. Plotësimi i kësaj kërkesë të shtuar mund të realizohet vetëm nëpërmjet ndjekjes së një politike monetare stimuluese.

Për ta mbyllur këtë diskutim, dëshiroj të detajoj më tej mekanizmin e transmetimit të politikës monetare, duke ilustruar mënyrën e trajtimit të problemeve të mësipërme.

Politika monetare lehtësuese nënkupton rritjen e masës monetare dhe uljen e kostos së parash në ekonomi. Në këndvështrimin e modeleve ekonomike neo-kejsianiste, të cilat janë dhe modelet bazë të përdorura për analizën e cikleve të biznesit, politika monetare stimuluese synon të ulë normat reale të interesit poshtë ekuilibrit afatshkurtër të tregut, të diktuar nga zhvillimet aktuale ekonomike. Rënia e normave reale të interesit nxit investimet, pasi ul koston e financimit të tyre. Ajo nxit gjithashtu konsumin, pasi ul stimujt për

kursim. Gjithashtu, politika monetare lehtësuese ndihmon në përcaktimin e një ekuilibri më të përshtatshëm të kursit të këmbimit, duke krijuar premisa për përmirësimin e balancës tregtare. Të tre këto kanale ndihmojnë zgjerimin e kërkesës agregate, rritjen e punësimit, të pagave reale, dhe të marzheve të fitimit të biznesit, duke i sjellë këto tregues në linjë me objektivin e inflacionit. Paralelisht me to, reagimi konsekuent i politikës monetare sinjalizon vullnetin e Bankës së Shqipërisë për të respektuar objektivin e saj të inflacionit, ndërsa qetësimi i trysnive të likuiditetit në tregjet financiare ndihmon në rritjen e vëllimit dhe në uljen e kostove të ndërmjetësimit financiar.

2. Instrumentet e përdorur dhe efektiviteti i tyre

Duke synuar adresimin e problematikës së sipërcituar, Banka e Shqipërisë ka përdorur uljen e normës bazë të interesit, rritjen e injektimit të likuiditetit në sistem dhe orientimin e publikut mbi kahun e ardhshëm të politikës monetare (forward guidance). Të tre këto instrumente kanë synuar – dhe kanë arritur – të ulin kostot e financimit në ekonomi (Grafiku 1). Gjithashtu, injektimi i likuiditetit ka qetësuar funksionimin e tregjeve financiare (Grafiku 2) ndërsa përdorimi i forward guidance ka ndihmuar në


sheshimin e lakores së normave e të interesit (Grafiku 3). Në prani të një reduktimi agresiv të normave të interesit nga ECB dhe FED, politika jonë monetare stimuluese ka frenuar edhe prirjet e mundshme mbiçmuese



Niveli i ulët i normës bazë të interesit sugjeron se hapësirat e përdorimit të mëtejshëm të këtij instrumenti janë ngushtuar. Ndonëse analizat tona sugjerojnë se stimuli aktual monetar është në nivele të përshtatshme, balanca e rreziqeve mbetet në kahun rënës dhe goditje të tjera mund të kërkojnë rritjen e stimullit monetar. Në rast se kjo ndodh, Banka e Shqipërisë gjykon se ka ende hapësirë për ulje të normës bazë të interesit. Përtej saj, politika monetare do të duhej t'i drejtohej instrumenteve jo-konvencionalë të politikës monetare.



Grafiku 1 Ecuria e normave të interesit (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku 2 Injektimi i likuiditetit nga B.Sh. dhe vëllimi i tregut ndërbankar (në mld lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë

abi

AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

investo ně optimizem

www.abi.al

të kursit të këmbimit. Këto faktorë kanë krijuar kushte më të përshtatshme financiare për mbështetjen e kërkesës agregate. Megjithëse mjedisi ekonomik e financiar karakterizohet nga prime të larta rreziku, të ushqyera më tej dhe nga politikat e rregullatorëve europianë, ato kanë ndihmuar në rritjen e huas në lekë (Grafiku 4). Gjithashtu, fenomeni i indeksimit të huave me normat



Politika monetare lehtësuese nënkupton rritjen e masës monetare dhe uljen e kostos së parasë në ekonomi. Në këndvështrimin e modeleve ekonomike neo-kejnsoniane, të cilat janë dhe modelet bazë të përdorura për analizën e cikleve të biznesit, politika monetare stimuluese synon të ulë normat reale të interesit poshtë ekuilibrit afatshkurtër të tregut, të diktuar nga zhvillimet aktuale ekonomike.



afatshkurtra të interesit nënkupton që politika jonë monetare stimuluese ka lehtësuar koston e shërbimit të borxhit për bizneset dhe familjet shqiptare.

Të gjitha këto zhvillime ilustrojnë faktin që stimuli monetar ka pasur një efekt pozitiv. Në mungesë të këtij stimuli: (i) normat e interesit dhe kursi i këmbimit do të ishin në nivele irracionalisht të larta; (ii) huadhënia, kërkesa agregate, rritja ekonomike dhe inflacioni do të ishin më të ulët; dhe (iii) kostot e shërbimit të borxhit e bilancet financiare të ekonomisë do të ishin më të përkeqësuar.

3. Sfidat e politikës monetare

Objektivi madhor i politikës monetare ka qenë dhe të mbetet ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Për sa kohë inflacioni dhe pritjet inflacioniste nuk janë ancoruar qëndrueshëm në objektiv, sfida e madhore e politikës monetare mbetet e hapur. Megjithëse përballlemi me trysni të dobëta inflacioniste, si në mjedisin e brendshëm dhe në atë të jashtëm, Banka e Shqipërisë është në gjendje ta fitojë këtë sfidë. Në afate të gjata, inflacioni mbetet një fenomen monetar dhe, si i tillë, subjekt i veprimit të politikës monetare.


Në afate më të shkurtra, politika monetare përballlet edhe me sfida të tjera:

- Oreksi i ulët për rrezik zbeh

efektivitetin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Reduktimi i primeve të rrezikut dhe zgjerimi i gatishmërisë për hua e investime kërkon ndërmarrjen e reformave strukturore, disa prej të cilave janë tashmë në proces. Megjithatë, duhet theksuar se fakti që ky mekanizëm mbetet funksional nënkupton që: (i) politika monetare tradicionale mbetet efektive, por (ii) doza e stimullit monetar duhet të jetë më e fortë sesa do të ishte në kushte ideale.


- Niveli i ulët i normës bazë të interesit sugjeron se hapësirat e përdorimit të mëtejshëm të këtij instrumenti janë ngushtuar. Ndonëse analizat tona sugjerojnë se stimuli aktual monetar është në nivele të përshtatshme, balanca e rreziqeve mbetet në kahun rënës dhe goditje të tjera mund të kërkojnë rritjen e stimullit monetar. Në rast se kjo ndodh, Banka e Shqipërisë gjykon se ka ende hapësirë për ulje të normës bazë të interesit. Përtej saj, politika monetare do të duhej t'i drejtohej instrumenteve jo-konvencionalë të politikës monetare. Përdorimi i këtyre instrumenteve kërkon kujdes, pasi natyra e tyre krijon shpesh efekte të padëshiruara anësore. Megjithatë, përmbushja e objektivit të inflacionit do të mbetet objektivi parësor i Bankës së Shqipërisë, pavarësisht instrumenteve të përdorur.

Grafiku 3 Pjerrësia e kurbës së normave të interesit (yield 12m – yield 3m, në p.p.)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku 4 Raporti i kredisë në lekë ndaj totalit (në përqindje)



Burimi: Banka e Shqipërisë



Aurora SULÇE

Gazetare

Që prej shtatorit të vitit 2011, Banka e Shqipërisë e ka ulur 16 herë normën bazë të interesit për lekun, në përpjekje për të nxitur kreditimin dhe në një reaksion zinxhir edhe ekonominë. Në verën e 6 viteve më parë, kosto e monedhës vendase ishte 5.25%, ndërsa sot ajo është në minimumin historik prej vetëm 1.25%.

Por sa ka arritur politika lehtësuese monetare e Bankës Qendrore qëllimin e saj?

Ulja e normës bazë të interesit u shoqërua me reagimin e bankave tregtare, që fillimisht ishte më i ndjeshëm në kahun e depozitave dhe më i ngadaltë te huat. Në periudhën në vijim, transmetimi i politikës monetare do të ishte më i qartë dhe do të prekte edhe bonot e thesarit dhe obligacionet, si dhe alternativat e tjera të investimit të fondeve private.

Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se interesat kanë rënë ndjeshëm dhe huat në lek nuk kanë qenë kurrë më të lira se sot. Norma mesatare e interesit të huave në lek, për të gjitha afatet e maturimit, zbriti në

Politika monetare në Shqipëri nën një pikëpyetje të madhe

Reformat strukturore janë kritikisht të domosdoshme për të siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme, por deri më tani, thjesht kanë munguar, duke e lënë të vetme Bankën e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të nxitur huadhënien e rrjedhimisht, për të vënë në lëvizje motorët e ekonomisë

maj të këtij viti në 7.2%, një rekord minimumi historik ky nga 11.4% që ishte në shtator 2011. Fakti që huat janë bërë më të lira nuk është shoqëruar me rritje të huadhënies, ashtu siç ishin dhe pritshmëritë. Në mars u shënuar një rigjallërim i lehtë i huas me 2.7 miliardë lekë, për të dytin muaj radhazi. Me bazë vjetore, kredia për ekonominë ka rënë me 2%, madje dhe të dhënat e prillit nuk ishin shumë inkurajuese, por dëshmuar për një veprimtari kredituese ende të zbehtë. Këto shifra tregojnë qartë se ngërçi i kreditimit nuk është shkaktuar nga çmimi i huasë, që sot ka rënë si pasojë e politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, por nga faktorë të tjerë.

Së pari është klima e biznesit, e përcaktuar si e përkeqësuar nga investuesit vendas e të huaj, por së fundmi edhe nga FMN. Sondazhet e fundit të Shoqatës së Investitorëve të Huaj, Dhomës Amerikane të Tregtisë, Dhomës Gjermane të Industrisë dhe Tregtisë, si dhe shoqatave të tjera të biznesit, janë një thirrje urgjente për eliminim burokracish, vendosje të shtetit ligjor, lehtësim të barrës fiskale dhe një marrëdhënie tjetër me institucionet shtetërore. Vrojtimi i Ndjesisë Ekonomike, i publikuar nga Banka e

Shqipërisë, tregoi një zbritje në tremujorin e parë të këtij viti në nivelin më të ulët që prej të njëjtes periudhë të vitit 2014, duke dëshmuar pesimizmin e fortë që përfshiu agjentët ekonomikë, konsumatorët dhe bizneset në sektorët e industrisë, tregtisë dhe shërbimeve. Ky tregues u përmirësua në tremujorin e dytë, duke shënuar një rritje me 6.2 pikë. Megjithatë, Banka e Shqipërisë vlerëson sërish se besimi i biznesit dhe ai konsumator mbeten të luhatsëm, çka ilustron pozitën ende të pakonsoliduar të kërkesës së brendshme private si motor i rritjes ekonomike. Paralelisht, të dhënat e Aktivitetit Kreditues për tremujorin e parë të vitit, treguan për rënie të kërkesës për hua nga individët dhe biznesi i madh, që janë dhe segmenti kryesor që marrin hua. Të dhënat e aktivitetit kreditues për tremujorin e dytë ilustruan se kërkesa e bizneseve për hua ka mbetur thuajse e pandryshuar. Sipërmarrja po punon sot me rreth 70 – 80% të kapacitetit, po sipas Bankës së Shqipërisë, e që tregon për vështirësitë që kalon biznesi, si gjeneruesi kryesor i punësimit, por dhe kontribuesi kryesor në rritjen ekonomike të vendit.

Së dyti, një tjetër faktor, që prej kohësh është bërë përcaktues në ven-

dimet e bankave për të dhënë hua, është portofoli i huave me probleme. Sipas të dhënave të Shoqatës Shqiptare të Bankave, në prill 2016 niveli i huave me probleme u rrit sërish, duke prekur kuotën e 20%. Edhe pse në maj ky tregues pësoi një rënie të lehtë prej 0.5%, sërish mbeti në nivelet shqetësuese të 19.5%. Krahasuar me fundin e vitit 2015, rritja vlerësohet në 1.3%. Në dhjetor, niveli i huave me probleme zbriti në 18.2%, pas fshirjes që bankat u bënë huave pa shpresë arkëtimi nga bilancet e tyre. Bankat pastruan bilancet nga huat që kishin 3 vjet pa u mbledhur. Pavarësisht se sistemi bankar fshiu rreth 23 miliardë lekë hua të humbura në vitin 2015, hua të tjera kanë kaluar në këtë kategori. Në gjendjen që ndodhet sot biznesi dhe rrjedhimisht dhe ekonomia, është e qartë se politika monetare e vetme nuk mjafton.

Gjithsesi, ulja e vazhdueshme e normës bazë të interesit ka pasur edhe kahun e saj negativ. Interesat e depozitave ranë ndjeshëm gjatë 6 viteve të fundit, duke e bërë pa leverdi mbylljen e kursimeve në banka. Sipas Bankës së Shqipërisë interesi mesatar vjetor i depozitave të reja në lekë në muajin maj ishte 0.84%, nga 0.93% në muajin e mëparshëm. Ky është niveli më i ulët historik i depozitave në lekë. Diferenca e madhe mes interesave të huave dhe depozitave, që vlerësohet në maj të këtij viti në 6.3%, dëshmon për rrezikun e lartë që perceptojnë bankat në huadhënie, e që padyshim buron nga situata e vështirë ekonomike në vend.

Rënia e interesave të depozitave nuk është shoqëruar me rritje të konsumit, çka mund të ishte një lajm i mirë për ekonominë. INSTAT raportoi se në shkurt inflacioni zbriti në 0.2%, në mars në 0.3%, në prill po në 0.3%, duke dëshmuar qartë tkurrjen e konsumit, që sipas Bankës së Shqipërisë është pasojë e pasigurisë së qytetarëve dhe bizneseve për shpenzuar dhe investuar. Vetëm në maj dhe qershor inflacioni filloi t'i largohej zonës së rrezikut, duke shënuar respektivisht



0.7% dhe 1.2%, por sërish ai mbetet larg objektivit prej 3% të Bankës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, si rezultat i uljes së normës bazë të interesit për lekun, një rënie të ndjeshme kanë pësuar edhe interesat e bonove të thesarit dhe obligacionet, të konsideruara si alternativa të mira investimi. Në ankandin e 7 qershorit, interesat e bonove 12 mujore zbritën në 1.24%, ndërsa interesi i bonove 6 mujore arriti në 0.95%, duke qëndruar për të dytin muaj rradhazi poshtë kufirit të 1%. Nga ulja e këtyre interesave ka përfituar qeveria, që e blen më lirë borxhin nga qytetarët e saj.

Politika monetare e 6 viteve të fundit ka kushtëzuar norma të ulëta interesi në ekonomi. Mjedisi me norma të ulëta interesi me qëllim stimulimin e ekonomisë funksionon, por në të njëjtën kohë, politikë bërësit duhet të ndër marrin reforma strukturore. Ky qëndrim mbështetet dhe nga z. Wim Mijs, Shefi Ekzekutiv i Federatës Europiane të Bankave, EBF, sipas së cilit nëse normat e ulëta nuk kombinohen

me reforma, atëherë mjedisi mund të bëhet i rrezikshëm. Reformat strukturore bëhen të domosdoshme, aq më tepër kur mundësitë për t'i dhënë stimuj fiskal ekonomisë kanë shtuar. Thënë ndryshe, qeveria nuk mund të ulë nivelin e taksave dhe tatimeve, për shkak të marrëveshjes me FMN-në. Rekomandimet e Bankës Botërore, BERZH-it dhe FMN-së theksojnë se Shqipëria deri në vitin 2025 duhet të fokusohet në zhvillimin e sektorit energjetik, heqjen e pengesave burokratike e administrative të sektorit të ndërtimit, që ai t'i rikthehet ritmeve të larta të tij, rritjen e investimeve dhe zgjerimin e sektorit bujqësor, vënien në eficiencë dhe modernizimin e sektorit të minierave, përmirësimin e klimës së biznesit, përmirësimin e kapitalit njerëzor dhe shtimin e investimeve në arsim dhe kërkim shkencor e inovacion, etj.

Përfundimisht, efektiviteti i politikës monetare dhe qëllimi kryesor të saj, nxitja e huadhënies po mban përsipër shenjën e madhe të PIKËPYETJES!



Dr. Spiro BRUMBULLI

Sekretari i ri i Përgjithshëm i Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB



AAB ka një rol të rëndësishëm në mbrojtje të interesave të bankave dhe të vepruarit në emër të tyre të jep forcë dhe prestigj, por edhe përgjegjësi. Shpesh, interesat e industrisë nuk lëvizin në të njëjtin drejtim me atë të politikëbërësve dhe kjo të vendos përballë tyre. Përballjet janë të karakterit ekonomik, me argument dhe në bazë të praktikave më të mira bashkëkohore.



Dr. Spiro BRUMBULLI

Sekretari i Përgjithshëm
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE, AAB

BANKIERI:

Së pari ju urojmë suksese në detyrën e re të Sekretarit të Përgjithshëm të Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB. Duke u "rikthyer" në sistemin bankar, si e gjeni sot AAB-në dhe vet sistemin bankar?

Sot jetojmë në një botë dinamike ku gjërat ndryshojnë shumë shpejt. Teknologjia ka dhënë mundësi të panjohura dhe realiteti ka njohur zhvillime përtej hamendësimeve. Bankat janë pjesë e këtij procesi. Tashmë nuk flitet thjesht për një model të ri të zhvillimit të biznesit bankar, por për realizimin e mjaft prej karakteristikave të tij. Nga ana tjetër, kriza e 2008-ës ka qenë një leksion historik, i përkthyer dhe menaxhuar në mënyrë shembullore nga të gjitha institucionet politikëbërëse, duke shmangur pasojat e rënda të krizës 1929 – 1932.

Në këtë kontekst, mjaft gjëra kanë ndryshuar në sistemin bankar, që kur unë u largova nga detyra drejtuese.

Për fat të keq, sistemi bankar nuk është në momentin e lulëzimit të tij (në botë kanë falimentuar mijëra banka) nga pikëpamja e zhvillimit të biznesit dhe e ndërmjetësimit financiar, por ndodhet në momentin e tij më të rëndësishëm, nga pikëpamja e konsolidimit për t'ju përshtatur një bote të re: globalizimit dhe zhvillimit të teknologjisë. Konkretisht, janë



Pas krizës së vitit 2008, sistemi bankar për asnjë moment nuk ka reshtur së dhëni hua. Nëse në vitin më të mirë të rritjes së huadhënies, viti 2008, huaja e re e dhënë ishte rreth 280 miliardë lekë, që nga viti 2009 e deri sot sistemi bankar ka dhënë mesatarisht çdo vit 250 miliardë lekë hua të re. Kjo do të thotë që nuk është se nuk ka huadhënie. Gjithsesi, rritja e portofolit të huas nuk ndodh më siç ndodhte me parë.

ndryshuar shumë rregulla, janë marrë masa më rigorozë në favor të mbrojtjes së interesit publik, është përcaktuar shumë më mirë që falimentimi i një banke të mos marrë fonde publike dhe të minimizohet rreziku sistematik. Gjithashtu, ka ndryshime të rëndësishme të llogaritjes së kapitalit rregullator dhe mjaftueshmërisë së kapitalit. Huat me probleme janë barrë dhe sfidë për adresime të sakta ligjore dhe operacionale. Aktualisht, po diskutohet shumë për nevojën e standardeve globale të profesionalizmit në industrinë bankare, si një mësim nga kriza botërore, në lidhje me kapitalin njerëzor.

Me pak fjalë, ndodhemi në një fazë konsolidimi të biznesit bankar për një perspektivë më të sigurt. AAB duhet të jetë në pararojë të mbrojtjes së interesave të industrisë që përfaqëson dhe të ndryshimeve që po ndodhin.

BANKIERI:

Si një ish-bankier me eksperiencë, sa sfidues paraqitet për ju ky rol i ri, ku tashmë duhet të përfaqësoni dhe mbromi interesat e gjithë sektorit bankar në Shqipëri?



Kur je drejtues, ke interesa që të bashkohen me kolegët e tjerë, sepse i takojnë gjithë industrisë apo mjedisit ku zhvillon biznesin, por ke edhe interesa që të ndajnë, sepse secili kërkon realizimin e objektivave të tij. Thënë ndryshe, je i përqendruar në të dy frontet, por theksi vendoset te ecuria e bankës që drejton. Si drejtues ke shumë përgjegjësi ekzekutive dhe produkti përfundimtar është lehtësisht i matshëm me treguesit e plan-biznesit.

Detyra e Sekretarit të Përgjithshëm, siç është sot, është në një rol bashkërendues, koordinues të shqetësimeve dhe problemeve të industrisë bankare, përfaqësimi në nivel të caktuar i bankave te institucionet e tjera, sigurimi i disa shërbimeve që janë në interes të përbashkët të industrisë, etj. Pra, nuk ka detyra mirëfillti ekzekutive, produkti përfundimtar është më i vështirë për t'u matur, por ndjeshmëria në publik është më e drejtpërdrejtë.

AAB ka një rol të rëndësishëm në mbrojtje të interesave të bankave dhe të vepruarit në emër të tyre të jep forcë dhe prestigj, por edhe përgjegjësi. Shpesh, interesat e industrisë nuk lëvizin në të njëjtin drejtim me atë të politikëbërësve dhe kjo të vendos përballë tyre. Përballjet janë të karakterit ekonomik, me argument dhe në bazë të praktikave më të mira bashkëkohore. Fakti që shumica e bankave janë me origjinë nga vendet e BE-së, na e bën më të lehtë paraqitjen e praktikave më të mira bashkëkohore, si argumentim dhe si drejtim ku duhet të shkojmë. Realizimi i tyre është një sfidë si dhe për shumë sektorë të tjerë të ekonomisë.

BANKIERI:

Në vijim të situatës nëpër të cilën kalon ekonomia e vendit dhe vet sistemi bankar, cili mendoni se do të jetë fokusi kryesor i AAB-së dhe gjithë sistemit bankar shqiptar, në drejtim të rritjes së kreditimit?

Ka një diskutim jo të vogël dhe me shumë interes, lidhur me ndërmjetësimin që aktualisht luan

sistemi bankar për kreditimin e ekonomisë. Shpesh dëgjojmë edhe komente të pavërteta dhe që ndërtohen mbi bazë perceptimesh, por duke u hedhur në publik, ato mund të krijojnë një perceptim më të gjerë tërësisht të gabuar. Më konkretisht, dua të theksoj se, që pas krizës së vitit 2008, sistemi bankar për asnjë moment nuk ka reshtur së dhëni hua. Nëse në vitin më të mirë të rritjes së huadhënies, viti 2008, huaja e re e dhënë ishte rreth 280 miliardë lekë, që nga viti 2009 e deri sot sistemi bankar ka dhënë mesatarisht çdo vit 250 miliardë lekë hua të re. Kjo do të thotë që nuk është se nuk ka huadhënie. Gjithsesi, rritja e portofolit të huas nuk ndodh më siç ndodhte me parë. P.sh., në vitin 2008



Ndodhemi në një fazë konsolidimi të biznesit bankar për një perspektivë më të sigurt. AAB duhet të jetë në pararojë të mbrojtjes së interesave të industrisë që përfaqëson dhe të ndryshimeve që po ndodhin.



portofoli i huas u rrit me 110 miliardë lekë, kurse këto vite rritet shumë pak, duke treguar një nivel ngopje te 600 miliardë lekë. Këtu ka dy arsye: (i) ri-pagesat janë shumë të larta, në krahasim me periudhën përpara vitit 2010 (në vitin 2008 portofoli i huas ishte 396 miliardë lekë, tani rreth 600 miliardë lekë); (ii) rritja ekonomike është e ulët (në vitin 2008 rritja ekonomike ishte 7.5%; viti i kaluar ishte 2.6%). Ndërkohë, ka ndryshime edhe të strukturës së huas që ndikon këta tregues.

Pra, huadhënia vazhdon dhe nuk kemi ndonjë pengesë për të kapërcyer. Sfidë është me rritjen ekonomike, me përmirësimin e klimës së zhvillimit të biznesit, sidomos në aspektin e drejtësisë dhe pronësisë. AAB-së i

duhet të mbrojë dhe nxisë realizimin e ndryshimeve të domosdoshme ligjore dhe reformat e tjera strukturore, për përmirësimin e klimës së biznesit. Në këtë kuadër, do të kategorizojë edhe përpjekjet për uljen e huave me probleme dhe qartësimin dhe forcimin e procesit të shitjes së një pasurie të vënë në hipotekë.

BANKIERI:

Si e shikoni në të ardhmen rolin e AAB-së? A mendoni se mund të ketë hapësira për një dimension të ri të saj?

Në kushtet kur ka ndryshuar industria bankare, kur mënyra se si zhvillohet biznesi bankar ka ndryshuar, nën efektin e ndryshimeve rregullatore dhe teknologjisë, ka vend gjithmonë për ndryshime dhe përmirësime, edhe të formave organizative, që i shërbejnë këtyre industrive. Edhe pse duhet të theksoj që nuk ka shumë rëndësi forma, por përmbajtja që prodhon ajo, ka vend për përmirësime edhe në AAB.

Stafi i deritanishëm ka bërë punë të lavdërueshme operacionale, ka ndërtuar infrastruktura shumë efektive të bashkëpunimit dhe përfshirjes së bankave në çdo problematikë, ka konsoliduar pjesën organizative dhe marrëdhëniet me shumë institucione, duke përfshirë ato ndërkombëtare, si dhe i kanë dhënë AAB-së një emër të respektueshëm. AAB duhet të jetë më e pranishme edhe për publikun e gjerë, duhet të gjejë forma e mënyra për të komunikuar edhe me të, sepse interesat e industrisë janë interesa edhe të publikut.

Në këtë drejtim mbetet për të bërë më shumë. Nuk mendoj se duhet rridimensionim, sepse themelet AAB i ka të shëndosha, por ne do të jemi të vëmendshëm ndaj ndryshimeve edhe në vendet e tjera, për të përfituar nga eksperiencia e tyre. Prirjet dhe zhvillimet në vendet e zhvilluara (si digjitalizimi bankar, edukimi financiar, etj.) janë në fokusin tonë, nëpërmjet marrëdhënieve tashmë të ndërtuara me shumë organizata të tjera.



Najada XHAXHA

Kryetare e Komitetit të Sistemit të Pagesave AAB

Ndikimi i zhvillimeve në fushën e teknologjisë dhe informatizimi i proceseve drejton sistemin financiar dhe atë bankar të mbështesë dhe të përfshihet në vorbullën e ndryshimeve të qenësishme, për të garantuar në treg siguri, efikasitet dhe reduktim të kostove, duke konsideruar të gjithë pjesëmarrësit në proces. Koordinimi i duhur, për të përcaktuar disa standarde të përbashkëta, që do të mundësojnë lehtësimin dhe ndër-veprimtarinë në shkëmbimin e informacionit, përbën një nga sfidat e sistemit bankar, si në këndvështrim të përdorimit në masë të instrumenteve të pagesave, ashtu edhe në perceptimin korrekt të tyre nga përdoruesit. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme të merret parasysh shumëllojshmëria në tregun e pagesave, ku aktorë të rinj janë tashmë prezent me shërbimet e tyre, dhe ku interesat dhe kërkesat e individëve, bizneseve

Unifikimi/Standardizimi i Urdhërpagesës

Rruga për rritjen e produktivitetit dhe lehtësimin e procesit

Unifikimi dhe standardizimi i urdhërpagesës sjell në një nivel më të lartë ndërtimin e një infrastrukture të përbashkët, të sigurt, të mbështetur në zhvillimet e fundit teknologjike, e cila do të udhëheqë procesin drejt përpunimit të automatizuar, duke kontribuar në uljen e kostove të procedimit (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta), kohën e përpunimit të të dhënave dhe reduktimin e gabimeve operacionale.

apo edhe institucioneve të ndryshme janë rritur kundrejt përshtatshmërisë dhe funksionimit të tyre.

Standardizimi i shkëmbimit të informacionit është kërkesë që diktohet edhe nga tregjet e zhvilluara, me të cilat Shqipëria bashkëvepron, apo synon të



Unifikimi dhe standardizimi i urdhërpagesës shihet i lidhur ngushtë edhe me ndikimin që do të ketë ai në ekonomi, në këndvështrim të biznesit. Rugëtimi drejt një procesi të automatizuar fillon me unifikimin dhe standardizimin e tij, i cili mundëson rritjen e produktivitetit, duke reduktuar kohën e procedimit të pagesës, uljen e gabimeve në plotësim kundrejt familjarizimit me të njëjtën formë, si dhe transparencën me klientin.



integrohet. Shembulli më konkret është krijimi i një fature/urdhri unik për pagesat në nivel Europian, i cili bazohet në standardet më të fundit “ISO 20022”;

ndërkohë që, ndërtimi i infrastrukturës së sistemeve të pagesave është tërësisht i orientuar në standardet Europiane të sistemeve SEPA & TARGET. Përgatitja në kohë e terrenit për jetësimin e duhur të këtyre standardeve është në fokus të zhvillimeve të ndërmarra në sistemin tonë bankar dhe më gjerë.

Në këtë kuadër, sistemi bankar në Shqipëri, i përbërë nga të gjitha bankat tregtare, vjen me disa propozime konkrete për zhvillim, si: Debitimi Direkt Ndërbankar, si një shërbim më shumë në treg, nëpërmjet të cilit klientët “biznes” dhe ata “individë” do të mund të realizojnë pagesat e faturave të ndryshme të shërbimeve publike, periodike apo celulare, duke pasur mundësi reale të zgjedhin bankën e tyre, me të cilën duan të bashkëpunojnë. Kjo do të krijojë hapësirën e duhur për të vlerësuar specifikat që secila bankë ofron, apo përmbush individualisht. Gjithashtu, projekte në fokus janë edhe mundësia e “clearing”-ut të monedhës Euro në Shqipëri, duke ndërtuar një sistem paralel të kësaj monedhe, në ngjashmëri me atë të monedhës kombëtare, si një vlerë e shtuar në industrinë e pagesave

të tregut vendas dhe unifikimi i formës së Urdhërpagesës, në nivel sistemi. Kjo e fundit përbën edhe projektin e radhës për sistemin bankar, por jo vetëm.

Nëpërmjet të dhënave të specifikuar në formën e unifikuar, qartësia e të kuptuarit të tyre do të lehtësojë përdorimin masiv të instrumentit të pagesës nga të gjithë pjesëmarrësit në treg, si nga individët ashtu edhe nga bizneset, duke ndikuar kështu edhe në reduktimin e përdorimit të instrumentit “cash” në lëvizjen e parasë, si dhe duke transformuar në kohë sjelljen ndaj institucionit bankë. Thjeshtësia e paraqitjes së instrumentit ndikon deri diku edhe në edukimin financiar të klientit, i cili drejtpërdrejt apo tërthorazi, duke kuptuar më qartë elementet e procesit, jep kontribut në saktësinë dhe ecurinë e transfertës dhe bëhet pjesë e vlefshme e tij.

Unifikimi dhe standardizimi i urdhërpagesës shihet i lidhur ngushtë edhe me ndikimin që do të këtë ai në ekonomi, në këndvështrim të biznesit. Rrugëtimi drejt një procesi të automatizuar fillon me unifikimin dhe standardizimin e tij, i cili mundëson rritjen e produktivitetit, duke reduktuar kohën e procedimit të pagesës, uljen e gabimeve në plotësim kundrejt familjarizimit me të njëjtën formë, si dhe transparencën me klientin. Ndërsa zgjerimi i përdorimit të këtij dokumenti në tregun e biznesit të madh dhe korporatave, përveç sa me sipër, realizon një përfaqje dhe bashkëveprim profesional, të shpejtë dhe unik të këtyre bizneseve me sistemin bankar në tërësi.

Për sa i përket këndvështrimit teknik, unifikimi dhe standardizimi i urdhërpagesës sjell në një nivel më të lartë ndërtimin e një infrastrukture të përbashkët, të sigurt, të mbështetur në zhvillimet e fundit teknologjike, e cila do të udhëheqë procesin drejt përpunimit të automatizuar, duke kontribuar në uljen e kostove të procedimit (të drejtpërdrejta dhe të tërthorta), kohën e përpunimit të të dhënave dhe reduktimin e gabimeve operacionale. Nga ana tjetër, bankat



të cilat në mënyrë periodike janë në proces zhvillimi dhe përmirësimi të sistemeve të tyre, në përputhje me standardet Europiane, do të jenë të parapërgatitura dhe nuk do të mbartin kosto shtesë në jetësimin e këtij dokumenti të unifikuar, i cili bazohet tërësisht në direktivat dhe rregullat e specifikuar në to.

Forma e unifikuar/standardizuar, e dakordësuar paraprakisht nga bankat tregtare, u miratua në mbledhjen e radhës së Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave, mbajtur pranë Bankës së Shqipërisë, në datë 24 maj. Mbetet detyrë e Komitetit Teknik të Pagesave, pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave, AAB, të ndjekë jetësimin e saj në sistemin bankar. Për këtë arsye, vënia në jetë e këtij dokumenti në treg do të realizohet me disa faza. Bankat do ta përdorin fillimisht atë në formë letre, në rrjetin e degëve të tyre, ku klientët do të kenë kontaktin e parë të drejtpërdrejtë me të. Me pas, në varësi të diversitetit dhe përkatësisë së secilës bankë, do të vijohet me jetësimin e saj nëpërmjet sistemeve operacionale, proces ky që kërkon më shumë kohë dhe mbart deri diku edhe kosto. Gjithashtu, e rëndësishme është edhe shtrirja e përdorimit të kësaj forme nga institucionet, shoqëritë dhe bizneset, deri në mundësinë e jetësimit të saj në sistemet e tyre të brendshme. Dy fazat e fundit mund të zhvillohen paralelisht

dhe mbetet detyrë e përbashkët realizimi dhe mirëfunksionimi i tyre.

Përmirësimi dhe përpunimi i mëtejshëm i kësaj forme do të mbetet nevojë, apo proces, në varësi të kërkesave të tregut dhe sistemeve të pagesave që operojnë në vend, të cilat ndryshojnë dhe diktohen nga zhvillimet e mëtejshme, apo ndikohen prej faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, në përputhje me standardet që koha kërkon.

Vazhdimësia dhe perfeksionimi i mëtejshëm i këtij dokumenti, deri në kodifikimin në të ardhmen të fushave përkatëse dhe leximin e tyre automatikisht nga sistemi, janë sfida në vijim për sistemin bankar. Gjithëpërfshirja e tregut, ai bankar, institucional dhe biznes, në bashkëpunim dhe përdorim të gjerë të kësaj forme, do të mbyllë ciklin e standardizimit dhe do të hapë mundësitë e inicimit të projektit E-invoicing, e konsideruar tashmë në tregun europian si një transfertë elektronike e informacionit të pagesës ndërmjet pjesëmarrësve në biznes (shitësit dhe blerësit). Ky do të jetë një proces tejet i automatizuar, i cili do të mundësojë një bashkëveprim të mirë të sistemeve të pagesave me transaksionet e brendshme të shoqërive. Kjo nismë do të parapërgatitë për të ardhmen mjedisin e duhur për standardizimin e faturës elektronike, në nivel ndërkuftar.



DEPOZITA MATRUSHKA

Fleksibilitet në tërheqje
pa humbur interesat e përfituara.

Deri në **5.2%** Lekë, **4.5%** USD, **2.1%** Euro:



BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Periodiciteti / Viti	1 ^{ta}	2 ^{ta}	3 ^{ta}	4 ^{ta}	5 ^{ta}	6 ^{ta}
Interesi në Euro	0.15%	0.25%	0.65%	1.45%	1.85%	2.10%
Interesi në Lekë	0.60%	0.85%	1.65%	3.60%	4.60%	5.20%
Interesi në USD	0.70%	0.95%	1.40%	3.10%	4.00%	4.50%



Fatih KARLI

Drejtor i Grupit të Bankingut Individual
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Gjatë ditëve të sotme një nga temat më të diskutuara në industrinë bankare është inovacioni. Ashtu sikurse dhe pjesën tjetër të botës, edhe bankat në Shqipëri po përpiqen fort që të përshtaten me këtë prirje. Në të vërtetë, inovacioni nuk është diçka e përkohshme dhe sezonale; ai po kthehet në mënyrën e vetme për të mbijetuar në këtë botë gjithnjë e më shumë në ndryshim dhe me kërkesa gjithnjë në rritje.

Qeveria shqiptare dhe Banka e Shqipërisë po i këshillojnë bankat që të transformojnë vetveten dhe të sjellin teknologjinë më të fundit në vend, për të ofruar shërbime me cilësi më të mirë për klientët. Shumica e bankave janë angazhuar fort në drejtim përmirësimit të cilësisë së tyre të shërbimit. Ne, si BKT, kemi ndërmarrë disa hapa drejt digjitalizimit. Kështu, po përpiqemi të gjejmë zgjidhje të përshtatshme, sipas kërkesave të klientëve tanë, por në këtë drejtim na duhet të përzgjedhim me kujdes, lidhur me ndërmarrjen e nismave për investime, pasi është fakt se industria bankare në Shqipëri

Produktet e reja në sistemin bankar shqiptar¹

Ne po përpiqemi të gjejmë zgjidhje të përshtatshme, sipas kërkesave të klientëve tanë, por në këtë drejtim na duhet të jemi edhe përzgjedhës, në drejtim të ndërmarrjes së nismave për investime, pasi është fakt se industria bankare në Shqipëri ka burime të kufizuara, për shkak të një ekonomie shkalle të vogël.

ka burime të kufizuara, për shkak të një ekonomie shkalle të vogël. Numri i kufizuar i konsumatorëve/përdoruesve për produktet bankare ndikon në efikasitetin e investimeve. Nëse kemi parasysh një bankë me aktive në nivelet e 50 - 100 miliardë dollarëve amerikanë, kjo e fundit ka më shumë fleksibilitet në drejtim të eksperimentimit me inovacionet, pavarësisht kostove, qoftë kjo edhe vetëm për arsye të imazhit të të qenit inovativ. Për shembull, shumë prej investimeve në portofolet elektronike (e-wallet) kanë dështuar në disa vende,



Sistemi bankar shqiptar është në fazat e para të këtij transformimi, por unë besoj se ne do ta mbyllim më shpejt sesa vendet e tjera hendequn që ekziston në këtë drejtim.



pavarësisht teknologjive të fuqishme të përdorura dhe kostove të mëdha marketing të harxhuara; shumë prej shoqërive të pagesave nëpërmjet telefonisë së lëvizshme i kanë mbyllur veprimtaritë e tyre, për shkak të vëllimeve të ulëta të transaksioneve në disa vende. Megjithatë, ekzistojnë edhe shumë

shembuj të shkëlqyer nga e gjithë bota, që u japin shpresë dhe inkurajojnë investuesit. Me fjalë të tjera, neve na duhet të zgjedhim zgjidhjet e duhura për ekosistemin shqiptar, në vend të kopjimit të prirjeve më të fundit, pavarësisht prej kërkesave ekzistuese apo të ardhshme nga klientët.

Me qëllim ofrimin e shërbimit më të mirë për konsumatorët, BKT ka zgjedhur strategjinë e pranisë aty ku janë klientët tanë dhe për të qenë të pranishëm në momentin e duhur. Në fillim të këtij viti, lançuan një aplikacion të ri bankar, për pajisjet Android dhe iOS, pasi klientët tanë duket se priren të përdorin më shumë pajisje komunikimi të lëvizshme. Ky aplikacion përmban gamën më të gjerë të transaksioneve në tregun shqiptar. Aplikacioni i siguron klientit me shumë lehtësi, duke përfshirë: hapje dhe mbyllje llogarish, transaksione lidhur me depozitat me afat, të gjitha llojet e transaksioneve me kartë, përfshirë këtu pagesat, paradhëniet, si dhe ndryshimin e limiteve nëpërmjet internetit, shkëmbime valutore, kryerjen e të gjitha llojeve të pagesave të faturave dhe debitime të drejtpërdrejta, mbushje krediti për të gjithë operatorët e telefonisë së lëvizshme, TV-të me pagesë, pagesën e gjobave të trafikut, të gjitha llojet e transfertave të parave, etj. Gjithsesi, kjo nuk nënkupton se kemi përfunduar investimet tona në drejtim të

¹ Ky shkrim është pjesë e prezantimeve në konferencën ndërkombëtare: "Bankingu dixhital në Shqipëri", organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, AAB, në 25 maj 2016.

“mobile banking, përkundrazi ky është një proces i vazhdueshëm. Pas lancimit të aplikacionit ne e kemi përmbushur tashmë objektivin e fund-vitit, brenda një periudhe të shkurtër kohe.

Përveç sa më lart, kemi vijuar investimet në “internet banking” dhe kemi shtuar funksione të reja, si: “Ndarja me Këste”, ku çdokush mund të bëjë transaksione “e-commerce” me kartat e kreditit të BKT-së nëpërmjet çdo tregtari në botë dhe çdo klient mund të blejë me këste me 0 % interes, nëpërmjet “internet banking”. Gjithashtu, klientët mund të përdorin edhe opsionin e blerjes me këste për transaksionet me kartë, jashtë vendit.

Ne besojmë se opsion i blerjes me këste është një lehtësi e madhe për klientët tanë. Për këtë arsye, kemi zgjeruar opsionin e blerjeve me këste për kartat tona të kreditit, pranë të gjithë tregtarëve që pranojnë kartat e BKT-së. Të gjithë POS-et e BKT-së, duke përfshirë edhe POS-et virtuale, japin shpërblime dhe ofrojnë opsionin e blerjeve me këste. Siç dihet tashmë, ne kemi lançuar gjithashtu edhe kartat e kreditit dhe POS-et pa prekje (“contactless”), për të shkurtuar kohën e transaksionit, si dhe për t’i dhënë të tjera mundësi në të ardhmen kartëmbajtësve tanë.

Përveç risive në kartat e kreditit, BKT ka shtuar edhe disa funksione në kartat e debitit. Klientët që përdorin kartat e debitit kanë mundësi të tërheqin fonde nga dyqanet tona partnere. Për shembull, nëse dikush ka nevojë për të holla ai/a mund të shkojë në një pikë karburanti, ku mund të kryejë një transaksion prej më shumë se 500 lekësh dhe njëkohësisht mund të tërheqë të holla, deri në 5000 lekë. Në këtë mënyrë ne duam të nxisim përdorimin e kartave të debitit gjatë blerjeve dhe gjithashtu t’i japim më shumë mundësi klientëve të tërheqin të holla. Për më tepër, BKT u ofron tashmë mbajtësve të kartave të debitit edhe mundësinë e blerjeve nëpërmjet internetit, duke u siguruar një mjedis të sigurt 3D.

Për shkak të mungesës së infrastrukturës, klientët e bankave mund t’i përdorin kartat e debitit për transaksione të kufizuara. Ne si BKT kemi bërë një investim disa vite më parë, për të zhvilluar një format për ATM-të për monedhën shqiptare, Lekun. Kjo do të na mundësojë neve, por dhe të gjitha bankave të tjera shqiptare, që të ofrojmë dhe opsionin “cash in”, apo depozitimin e fondeve, nëpërmjet ATM-ve. Për shkak të vështirësive gjatë fazës së zhvillimit, që rridhnin nga disa rrethana unike për monedhën shqiptare

dhe ndryshimeve në legjislacion, projekti u zgjat pak në kohë, por më në fund procesi i licencimit përfundoi me sukses. Përveç funksionit të depozitimit të fondeve, kemi shtuar edhe disa karakteristika të reja të ATM-të tona, si: rimbushja dhe pagesat e kartës (për klientin ose për një person tjetër).

Klientët tanë mund të komunikojnë me ne, duke përdorur rrjetet sociale. Ne kemi disa aplikacione në Facebook, ku një prej tyre është vetëm për ankesa dhe këshillime. Kemi lançuar edhe shërbimin në WhatsApp, për t’i ofruar një alternativë mjaft të popullarizuar për komunikim klientëve tanë. Për më tepër, kemi lançuar edhe shërbimin “call center” për huat për strehim. Agjentët tanë ofrojnë këshilla për klientët që kanë interes të blejnë shtëpi.

BKT po përdor gjithashtu edhe instrumente komplekse të përpunimit të ngjarjeve, për të menaxhuar komunikimet, sikundër po punojmë për integrimin e të gjithë kanaleve të komunikimit, me qëllim ofrimin e një komunikimi shumëkanalësh për klientët tanë.

Ajo çka kemi nevojë janë disa ndryshime

në rregullore, që do të na japin mundësi të jetësojmë disa risi; pjesa dërrmuese e rregulloreve supozojnë se transaksionet duhet të finalizohen brenda mjedisit të degës. Kjo e kufizon zhvillimin e disa produkteve dhe shërbimeve. Për shembull, bankat në Shqipëri duhet të jetë të afta të japin hua për individët brenda disa sekondave. Këtu nuk bëhet fjalë për kohën kur duhet thënë “Po”, ose kohën kur duhen akorduar “paratë në dorë”. Pengesa kryesore nuk është infrastruktura teknike, por rregulloret. Ne kemi nevojë për disa përmirësime në infrastrukturë, si p.sh.: informacione më të plota nga Regjistri i Kredive, përfshirë këtu dhe pikë-vlerësimin, një sistem më të plotë dhe efikas adresash, si dhe ndarjen e të dhënave në internet, etj. Kjo mund të na ndihmojë të zvogëlojmë huat me probleme në sistemin bankar.

Përmbledhtazi, digitalizimi është një udhëtim dhe sistemi bankar shqiptar është në fazat e para të këtij transformimi, por unë besoj se ne do ta mbyllim më shpejt sesa vendet e tjera hendekun që ekziston në këtë drejtim.

BKT WhatsApp
Në çdo moment 😊

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

4 22 66 288 | www.bkt.com.al

0674000018



Anila TOLLKUÇI

Drejtoare e Divizionit të Sigurisë
RAIFFEISEN BANK SHQIPËRI

Digjitalizimi është shkatërruesi më i madh i sektorit bankar në ditët e sotme. Në artikullin e tij “Prirjet në banking: Ku e shohin ekspertët industrinë sot dhe nesër”, 2015, Cooper pohon se ... bankingu digjital do të vazhdojë t’i heqë një përqindje gjithnjë e më të madhe biznesit të bankigut tradicional, duke i nxjerrë tepër disa prej degëve të bankave, ndërsa pjesa tjetër e tyre do të orientohet drejt teknologjisë dhe vetë-shërbimit. Bankingu bazohet në besim, kur është fjala për bankingun digjital dhe më konkretisht për bankingun online, siguria është një ndër faktorët me më shumë peshë, që ndikon në perceptimin e klientëve dhe besimin e tyre në një bankë. Në sondazhin e tyre rreth besnikërisë elektronike të klientëve ndaj bankigut elektronik, Raitani & Vyas (2014) theksojnë se, shumica e të anketuarve tregojnë një mungesë besimi në bankingun elektronik. Ata sugjerojnë që bankierët duhet t’i edukojnë klientët

Siguria në bankingun digjital



Për bankat është e nevojshme të zhvillojnë një ekosistem me disa shtresa, duke kombinuar kontrollet parandaluese dhe zbuluese në të gjitha shtresat, të integruara këto plotësisht në gjithë bankingun digjital dhe atë online.



lidhur me përdorimin e bankigut online, sikundër dhe për sigurinë dhe privatësinë e llogarive të tyre online.

Studime të ndryshme tregojnë se investimi në siguri ndihmon jo vetëm për të përforcuar besimin e klientëve, por edhe për një pranim dhe përdorim më të madh, nga ana e klientit, të bankigut digjital.

Duke iu referuar një studimi për bankat tregtare në rrafsh global, të kryer nga Ernst & Young (2015), gati 50 për qind e të anketuarve thonë se janë të shqetësuar rreth sigurisë digjitale dhe kjo është arsyeja kryesore që ata nuk përdorin shpesh kanalet online dhe ato të lëvizshme.

Çfarë nënkuptohet me siguri në botën digjitale në përgjithësi?

Ekzistojnë disa aspekte të sigurisë që duhet të merren parasysh gjatë transformimit digjital, në mënyrë që, nga perspektiva e bankave ai të ketë sukses; ky është ekosistemi i sigurisë së brendshme. Për bankat është e nevojshme të zhvillojnë një ekosistem me disa shtresa, duke kombinuar kontrollet parandaluese dhe zbuluese në të gjitha shtresat, të integruara këto plotësisht në gjithë bankingun digjital dhe atë online. Sigurisht që një sistem i tillë përfshin në vetvete teknologji, procese dhe njerëz, staf të sigurisë të aftë dhe të kualifikuar, të cilët

e kuptojnë klientin, duke krijuar kështu në mënyrë aktive një mjedis të sigurt për klientët për të përdorur shërbimet bankare.

Në artikullin e tyre “Teknologjia shtyn bankat të zhvillojnë dhe fuqizojnë klientët”, 2010, nga Teller Vision, ...pranimi masiv i bankigut të lëvizshëm, pagesat nëpërmjet celularit dhe ata të drejtpërdrejta mes personave do të modelojnë qasjen e institucioneve financiare ndaj klientëve dhe mediat sociale do të vazhdojnë të modelojnë marrëdhëniet e klientëve me institucionet e tyre financiare. Mënyra se do të bashkëveprojnë bankat me klientët në epokën digjitale do të ndikohet shumë nga



OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare, shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative " AL-KHARAFI
(pranë Fakiut Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405

prirja digjitale; nga pikëpamja e sigurisë kjo kërkon një qasje të re në drejtim të asaj se si të minimizohen rreziqet në mënyrë sa më proaktive. Bankave do t'u duhet të pajisin dhe projektojnë ekosistemin e sigurisë në mënyrë të tillë që të:

- parandalojnë materializimin e pjesës dërrmuese të kërcënimeve, nëpërmjet përdorimit të teknologjive novatore.

- parashikojnë përpjekjet për mashtrime elektronike, përmes kombinimit të teknologjisë, proceseve dhe aftësive, ose të paktën të jenë në gjendje ti zbulojë menjëherë ato, duke kufizuar në këtë mënyrë ndikimin negativ financiar.

Rruga drejt revolucionit digjital dhe në veçanti në bankingun online e bën gjithnjë e më të domosdoshëm për bankat ruajtjen e besimit të klientëve, duke u siguruar atyre një mjedis të sigurt. Një strategji e mirë, që merr parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë më fort mbi perceptimin dhe përdorimin e shërbimeve bankare nga klientët, duhet ta kthejë sigurinë në një nga gurët e themelit për zhvillime të tilla. Duke qenë në zemër të strategjisë digjitale, nga njëra anë siguri në vetvete duhet të jetë në krye të përdorimit të teknologjive të reja, duke shkuar deri tek analizat parashikuese, por nga ana tjetër ajo duhet të konsiderohet dhe ekzistojë në çdo fazë dhe hap të strategjisë digjitale. Një faktor madhor që i jep formë ekosistemit të sigurisë është sigurisht mjedisi i jashtëm dhe peizazhi i kërcënimeve. Përgjithësisht, për çdo organizatë, e për bankat në mënyrë të veçantë, është një sfidë e madhe të qëndrosh, në mënyrë proaktive, në krye dhe një hap përpara zhvillimeve të jashtme të peizazhit (digjital dhe online) të kërcënimeve.

Peizazhi i kërcënimeve ka njohur zhvillim shumë në vitet e fundit, ku mashtrimet online janë bërë edhe më të sofistikuar, ku tregjet informale janë zhvilluar deri në atë pikë sa po krijojnë paketa dhe instrumente, me kosto disa qindra dollarë, që ofrojnë një kthim të madh nga investimet. Sipas analizës tremujore të Group – IB (një shoqëri e specializuar në parandalimin dhe hetimin e krimeve të teknologjisë së lartë dhe mashtrimeve online) bëhet e ditur se, që nga fillimi i vitit 2016 vihet re një rritje e fortë në numrin e sulmeve që kanë në shënjestër bankat në të gjithë botën,

përveç sulmeve ndaj klientëve të tyre. Nga instrumentet më të mira që bankat do të duhet të përdorin në epokën digjitale është e-Intelligence (inteligjenca elektronike), kuptimi në thellësi i sulmeve kibernetike, evolucioni i tyre, metodat dhe çdo hollësi që banka mund të marrë dhe analizojë, me qëllim që ta ndihmojë atë në modelimin më të mirë të mbrojtjes së saj. Në këtë drejtim, bankat duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në shkëmbimin e të dhënave në kohë reale, si dhe me palët e treta të specializuara, të tilla si Grupi - IB, FS-ISAC.

Në evolucionin e sotëm digjital, bankat duhet t'i pajisin strategjitë në mënyrë të tillë që t'i:

- marrin të dhëna të tilla dhe

- përdorin (operacionalizojnë) këto të dhëna.

Kjo e fundit sigurisht duhet të ndërtohet në kuadër të ekosistemit të sigurisë së bankave, ndërsa e para është diçka për të cilën bankat duhet të bien dakord mes tyre. Megjithëse ekzistojnë disa komunitete, disa prej tyre shumë efikase (por dhe të shtrenjtë), ka ardhur koha që bankat të marrin në konsideratë krijimin e komuniteteve (pa pagesë), ku informacioni i thelluar ndahet dhe përthithet në kohë reale.

Tregu bankar shqiptar ka ende një rrugë të gjatë për të bërë në vënien në jetë të këtyre parimeve, përgjatë rrugës digjitale. E fundit, por pjesa më e rëndësishme e mozaikut, është pikërisht kthimi i klientit si pjesë integrale e këtij ekosistemi. Ndërkohë që bankat përqafojnë gjithnjë



Rruga drejt revolucionit digjital dhe në veçanti në bankingun online e bën gjithnjë e më të domosdoshëm për bankat ruajtjen e besimit të klientëve, duke u siguruar atyre një mjedis të sigurt. Një strategji e mirë, që merr parasysh të gjithë faktorët që ndikojnë më fort mbi perceptimin dhe përdorimin e shërbimeve bankare nga klientët, duhet ta kthejë sigurinë në një nga gurët e themelit për zhvillime të tilla.



e më shumë digjitalizimin dhe rrisin ekspozimin e tyre online, klienti sigurisht është një lidhje shumë e rëndësishme, por me një ndikim të madh në zinxhirin e përgjithshëm të bankingut digjital. Thuajse të gjitha sulmet e deritashme ndaj bankingut online ndodhin, ose kanë pikënisjen në nivel klientësh, që janë dhe “frutat që kapen me dorë”.

Në një studim shumë të veçantë, ku u analizua perceptimin i sigurisë ndaj bankingut online në tregun kroat dhe serb, Makarević et.al (2014), arritën në përfundimin se klientët kroatë dhe serbë nuk kanë perceptime të njëjta ndaj bankingut online. Ndërsa klientët kroatë, që nuk kanë frikë dhe keqkuptime, të vetëdijshëm për rëndësinë e karakteristikave të prekshme, mendojnë se bankat janë të afta të mbrojnë plotësisht privatësinë e tyre dhe se bankat bëjnë të pamundurën për të përmirësuar fshehtësinë e transaksioneve online, klientët serbë nuk mendojnë se bankat janë të afta të mbrojnë privatësinë e tyre plotësisht. Megjithëse ata mendojnë se bankat bëjnë më të mirën për përmirësimin e fshehtësisë së transaksioneve online, perceptimet e tyre pasqyrojnë frikë, keqkuptime dhe shqetësim. Rezultatet treguan gjithashtu se, klientët serbë nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e karakteristikave të prekshme lidhur me sigurinë gjatë kryerjes së bërë transaksioneve online.

Mbetet shumë interesante të shihen rezultatet e një kërkimi të tillë për tregun shqiptar, madje duhet kryer për një periudhë disa vjeçare, për të parë prirjet me kalimin e kohës. Pavarësisht nga mungesa e një kërkimi të tillë, është e qartë se nevojitet më shumë edukim për klientët në këtë drejtim. Ata duhet të sillen në ekosistemin e sigurisë, duhet të informohen rreth tij dhe ta njohin atë, ta kuptojnë dhe të jetojnë me të. Vetëm në këtë mënyrë perceptimi klientëve dhe më e rëndësishmja, sjellja ndaj bankingut digjital dhe online, mund të ndikohet pozitivisht. Nisur nga fakti i ndikimit që ka në përgjithësi mbi përvojën dhe perceptimin e klientit, siguria bëhet një pikë e rëndësishme, të cilën bankat duhet ta trajtojnë gjerësisht gjatë zhvillimeve digjitale, në një mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse. Digjitalizimi, një epokë e re le ta bëjmë të sigurt!



Enkelelda SHEHI

Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive
AUTORITETI I MBIKËQYRJES
FINANCIARE, AMF

Tregjet financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), konkretisht tregu i sigurimeve, kapitaleve dhe fondeve të investimeve, si dhe fondeve private vullnetare të pensioneve, kanë vite që vijojnë prirjen drejt zgjerimit. Në vitin 2015, totali i aktiveve në këto tregje arriti vlerën 96.1 miliardë lekë, me një rritje prej 8% kundrejt vitit 2014. Treguesi i aktiveve gjithsej ndaj PBB-së për vitin 2015 arriti në nivelin më të lartë të vërejtur deri më sot, prej 6.7%. Për rrjedhojë, edhe kontributi i këtyre tregjeve në ndërmjetësimin financiar, është rritur ndjeshëm. Struktura e tregjeve edhe gjatë vitit 2015 konfirmoi ndryshimin strukturor të vërejtur në tre vitet e fundit. Tregu më i madh për t'u mbikëqyruar nga pikëpamja e aktiveve mbetet tregu i fondeve të investimeve. Megjithatë këto fonde filluan veprimtarinë vetëm katër vite më parë, tashmë renditen si tregu i dytë më i madh në vend, pas tregut bankar, duke zënë në vitin 2015 rreth 70% të peshës së tregjeve që mbikëqyren nga AMF, apo 4.7% të PBB-së. Ky zgjerim

Roli dhe sfidat e AMF-së në kuadër të menaxhimit të rrezikut e lehtësimit monetar

Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm me norma të ulëta interesi sjell disavantazhe në aspektin e rritjes së rreziqeve në tregjet financiare, pasi investuesit do të ndërmerrnin rreziqe më të mëdha, si rezultat i zhvendosjes së kursimeve drejt alternativave jashtë sektorit bankar, e madje edhe jashtë sistemit financiar në tërësi.

tregon interesin që kanë investuesit vendas për produkte të reja kursimi apo investimi, por njëkohësisht është favorizuar edhe nga mjedisi mbizotërues prej vitesh me norma të ulëta të interesit, që zbatohen për produktet bankare të kursimeve.

Pavarësisht se normat e ulëta të interesit ishin një ndër faktorët që favorizuan zhvillimin e fondeve të investimit, një politikë monetare lehtësuese përbën një sfidë për punën e AMF-së. Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm me norma të ulëta interesi sjell disavantazhe në aspektin e rritjes së rreziqeve në tregjet financiare, pasi investuesit do të ndërmerrnin rreziqe më të mëdha, si rezultat i zhvendosjes së kursimeve drejt alternativave jashtë sektorit bankar, e madje edhe jashtë sistemit financiar në tërësi. Nga të tre tregjet që mbikëqyr AMF, tregu i fondeve të investimit dhe tregu i pensioneve private janë më të ekspozuarit ndaj rrezikut të tregut, si pjesë e rrezikut sistemik. Arsyeja qëndron në faktin se investimet e shoqërive të sigurimit janë të përqendruara kryesisht në depozita dhe bono thesari, kurse dy tregjet e tjera kanë një portofol investimi e si rezultat mund të jenë më të ekspozuara ndaj rrezikut të normës së interesit.

AMF i kushton vëmendje të veçantë vendosjes së rregullave dhe përgatitjes së bazës ligjore për trajtimin sa më të mirë dhe koherent të rreziqeve, brenda sistemit financiar shqiptar. Pikërisht, lidhur me tregun

e fondeve të investimeve AMF ka përmirësuar bazën rregullatore, kryesisht në drejtim të forcimit të regjimit të transparencës ndaj klientit dhe përmirësimit të kërkesave për administrimin e rrezikut në treg. Gjithashtu, në vitin 2015 u miratuan rregullorja për administrimin e likuiditetit dhe u ndryshua rregullorja për vlerësimin e aktiveve të fondeve. Miratimi i këtyre dy rregulloreve shënoi përbushjen e rekomandimeve, në kuadër të misionit të asistencës teknike të BB-së dhe FMN-së. Ndryshimi ligjor më i rëndësishëm për këtë vit është amendimi i disa ndryshimeve të ligjit "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", me synim forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK). Ky ligj vë theksin në forcimin e administrimit të rreziqeve të tregut të fondeve të investimit dhe operatorëve të këtij tregu, me synim kontrollin dhe zbutjen e rreziqeve kundrejt të cilave ekspozohen këto fonde, si dhe përforcimin e mbrojtjes së interesave të investuesve. Gjithashtu, projekti i ardhshëm "Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së: Fokusi të zhvillimi i tregut të kapitaleve", i cili zhvillohet me mbështetjen e Bankës Botërore dhe SECO, synon të mbështesë AMF-në veçanërisht në forcimin e kapaciteteve për të mbikëqyruar tregun e fondeve të investimit.

Për sa i përket tregut të pensioneve vullnetare, AMF po punon për miratimin

e manualit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun, që përfshin hapat e identifikimit, përkufizimit, klasifikimit dhe reagimit ndaj rreziqeve në këtë treg. Ky manual është produkt i projektit tashmë të përfunduar për mbikëqyrjen dhe zgjerimin e pensioneve private vullnetare.

Lidhur me tregun e sigurimeve, rreziqet më të identifikueshme të cilat ndikojnë në këtë treg janë ai i likuiditetit, normës së interesit dhe besueshmërisë. Konkretisht, nuk ka ende një ligj për sigurimin ndaj rrezikut nga katastrofat që të mund ta identifikonim edhe një rrezik të tillë, por ky mund të bëhet faktor në të ardhmen me kalimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga katastrofat, i cili është ende në fazë shqyrtimi. Nga këto rreziqe peshën kryesore e zë ai i likuiditetit. AMF duhet të sigurojë që shoqëritë e sigurimit kanë kapital/aftësi paguese, rezerva teknike/matematike dhe likuiditete të mjaftueshme, për të mbuluar detyrimet ndaj klientëve. Ndaj, në përbushje të objektivit të monitorimit të rrezikut të likuiditetit, këtë vit është miratuar rregullorja “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe ri-sigurimit”. Kjo rregullore i detyron shoqëritë e sigurimit që të monitorojnë me bazë ditore dhe të ruajnë një nivel të mjaftueshëm likuiditeti, i cili raportohet pranë AMF-së çdo muaj. Në rastet e shkeljeve të nivelit të kërkuar duhet të raportojnë brenda 24 orëve, bashkë me masat për rregullimin e situatës.

Rreziqe të tjera mund të përmendim rrezikun e besueshmërisë, por duke qenë

se tregu shqiptar në këtë aspekt është shumë i kufizuar, ky rrezik shihet si jo shumë domethënës. Investimet e aktiveve të shoqërive të sigurimeve konsistojnë kryesisht në depozita bankare (rreth 34% për vitin 2015) dhe letra me vlerë qeveritare (rreth 13% për vitin 2015), të cilat janë me rrezik të ulët. Gjithashtu, rreziku i normës së interesit sjell rënien e të ardhurave nga investimet e aktiveve dhe çon në kërkesë për rritje të rezervave teknike. Në kushtet e tregut shqiptar të sigurimeve, ku raport dëme/prime neto në tregun e sigurimit të Jotës është 39%, rënia e normës së interesit nuk paraqet një rrezik imediat për aftësinë paguese të shoqërive të sigurimit.

Ligji nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” mundësoi fillimin e zbatimit nga AMF të metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rrezikun në tregun e sigurimeve, e cila bazohet në Manualin e Mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimit, ka hyrë në fuqi në datë 31.10.2014. Koncepti bazë i metodologjisë është të identifikojë fushat me rrezik më të lartë në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit dhe më tej, aty ku është e nevojshme, të punojë me drejtuesit e shoqërisë për të reduktuar rreziqet në nivele të pranueshme. Objektivi është parandalimi në kohë i problemeve financiare që mund t'i ndodhin një shoqërie sigurimi. Fokusi i AMF-së është edhe tek provizionimi i kujdesshëm dhe praktikatat e tarifimit në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik, si segmenti me peshën kryesore në tregun e sigurimeve, sepse qëndrueshmëria e këtij

portofoli përcakton shëndetin financiar të tregut në tërësi. Masat e përmendura më sipër, përveç synimit të shmangies së mungesës së likuiditetit dhe përfshirjes së vlerësimit të rreziqeve në praktikën e mbikëqyrjes, shënojnë edhe një përafrim me standardet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, miratimi i bazës ligjore dhe rregulloreve shënon përbushjen e rekomandimeve në kuadër të misionit të asistencës teknike të BB-së dhe FMN-së.

Sfida më e madhe për AMF-në mbetet zbatimi rigoroz i ligjit dhe rregullave ekzistuese nga shoqëritë e sigurimit, rritja e cilësisë së raportimit, ngritja e standardit dhe përafrimi i tregut të sigurimeve me standardet e BE-së, si edhe zhvillimi dhe zgjerimi i gamës së produkteve të sigurimit. Në funksion të administrimit të rreziqeve në treg, janë kryer inspektime të përbashkëta me Bankën e Shqipërisë, si dhe po punohet për ndërtimin e një protokollit veprimesh për ushtrimin e mbikëqyrjes së konsoliduar në ato veprimtari të institucioneve financiare, ku përgjegjësia mbikëqyrëse është e të dy autoriteteve. Me përbushjen e këtij objektiv synohet të reduktohen mundësitë e transferimit të rrezikut nga një segment në një tjetër të sistemit financiar, apo që rreziqe të caktuara të mbeten pa u mbikëqyruar. Profili i rrezikut të tregjeve, që mbikëqyren nga AMF, analizohet edhe në kuadër të rreziqeve sistemike për sistemin financiar në tërësi dhe është pjesë e diskutimeve që kryhen në kuadër të Grupit Këshillimor për Stabilitetin Financiar (GKSF).





KREDI PËR PUSHIME



**Ju shihni ëndrra me pushime,
ne ju mundësojmë pushimet e ëndrrave.**

Shuma e financimit - Deri në 500.000 lekë.

Afati maksimal i shlyerjes - 24 muaj.

Normë interesi fikse 4.8%.

3 muaj pa pagesë principali.

 **CREDINS bank**
Ne flasim gjuhën tuaj!

Në bashkëpunim me Aleancën Globale për Lehtësimin e Tregtisë¹

Një perspektivë e biznesit mbi përfitimet e marrëveshjes për lehtësimin e tregtisë së OBT-së



Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë synon të përshpejtojë procedurat doganore; ta bëjë tregtinë më të lehtë, më të shpejtë dhe më të lirë; të ofrojë qartësi, efikasitet dhe transparencë; të zvogëlojë burokracinë dhe korrupsionin, si dhe të përdorë zhvillimet teknologjike.



Lehtësimi i tregtisë është termi i përgjithshëm i një pakete masash për të ndihmuar heqjen e burokracisë në dogana. Procedurat doganore mund të ngjajnë si të fshehta, mirëpo në botën reale ato janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Kërkesat e tepërta në dogana paraqesin sfida reale për shoqëritë tregtare të të gjitha përmasave dhe e bëjnë veçanërisht të vështirë tregtinë në nivel ndërkombëtar, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Mjaft studime vërtetojnë se përmirësimet në administrimin doganor ndikojnë pozitivisht në prodhimin e brendshëm bruto dhe në krijimin e vendeve të punës. Procedurat doganore ndikojnë në vendimet për investim të kompanive dhe luajnë një rol në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në një vend. Kompanitë konsiderojnë si më të favorshme për investime të reja lokale ose shtim të veprimtarive të biznesit vendet ku janë bërë përmirësime thelbësore në lehtësimin e tregtisë.

Çfarë është Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë?

Në vitin 2013, përmes një miratimi historik global, anëtarët e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) ranë dakord për një marrëveshje gjithëpërfshirëse, me qëllim shkurtimin e burokracisë në kufij, e njohur si Marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë (MLT). Marrëveshja për

Lehtësimin e Tregtisë synon të përshpejtojë procedurat doganore; ta bëjë tregtinë më të lehtë, më të shpejtë dhe më të lirë; të ofrojë qartësi, efikasitet dhe transparencë; të zvogëlojë burokracinë dhe korrupsionin, si dhe të përdorë zhvillimet teknologjike. Nëse zbatohet, MLT-ja, ndër të tjera, do të rrisë bashkëpunimin ndërmjet agjencive qeveritare, do të thjeshtojë kërkesat doganore dhe nxisë përdorimin e dokumenteve elektronike.

Përse është e rëndësishme një marrëveshje globale për masat doganore?

NVM-të janë të prekura në mënyrë jo-përpjestimore nga proceset burokratike doganore dhe një hulumtim i Forumit Ekonomik Botëror sugjeron se zbatimi i MLT-së do të shkaktonte, në disa ekonomi, rritje në shitjet ndërkufitare të NVM-ve, nga 60% deri 80%. Raporti Botëror mbi Tregtinë i OBT-së për vitin 2015 tregon gjithashtu se zbatimi i plotë i MLT-së do të zvogëlojë kostot e tregtisë globale, mesatarisht me 14.3%. Më së shumti, këto përfitime, do të ishin më të mëdha për ekonomitë në zhvillim dhe ato të reja, ku bizneset dhe konsumatorët do të përftonin të mirat e një integrimi më të madh në tregjet globale. Reformat për lehtësimin e tregtisë do t'i mundësonin shoqërive tregtare tregtimin për herë të parë në nivel ndërkombëtar, veçanërisht kur interneti

hap dyert për mundësi të reja për NVM-të dhe start-up-et.

Ndikimi më i madh mbi kostot e tregtisë për vendet me të ardhura mesatare të sipërme, sikurse është edhe Shqipëria, parashikohet të vijë nga: riorganizimi i procedurave doganore (3.6%); automatizimi i proceseve tregtare dhe doganore (2.8%); sigurimi i informacionit të lidhur me tregtinë (2.4%); dhe sigurimi i rregullave të përparuar mbi çështjet doganore (2.4%). Shumë problematika të lidhura me kufijtë, me të cilat përballen qeveritë, sikurse kontrabanda dhe mashtrimi, mund të trajtohen dhe zgjidhen përmes reformës së lidhur me MLT-në.

Pse MLT është e rëndësishme për Shqipërinë?

Shqipëria ratifikoi Marrëveshjen për Lehtësimin e Tregtisë (MLT) më 10 maj 2016, duke u bërë vendi i 79të anëtar i OBT-së që iu bashkua këtij angazhimi. MLT-ja do të hyjë në fuqi dhe do të mund të zbatohet plotësisht me ratifikimin e 109 vendeve anëtare të OBT-së. Zbatimi i MLT-së do të përbëjë një potencial të rëndësishëm për të rritur konkurrencën e industrisë shqiptare në tregjet globale.

Një raport i OECD-së i vitit 2016 mbi konkurrueshmërinë në Europën Juglindore (EJL), tregon se Shqipëria nuk ndodhet në avantazh mes vendeve të EJL-së, veçanërisht

për sa i takon kohës për zhdoganim. Një studim tjetër i Zyrës së OKB-së mbi Drogën dhe Krimin (UNODC), tregon gjithashtu se, efikasiteti në importe mund të kushtëzohet nga korrupsioni i raportuar në kufij. Faktikisht, i gjithë rajoni i EJT-së vuan nga kushtëzime në eksporte, të krijuara nga kërkesat për përbushjen e



Efektet e Tregtisë nga Reforma Doganore: Të dhëna nga Shqipëria

Një raport i Bankës Botërore i vitit 2015, tregon se gjatë periudhës 2007-2012 ulja e normave të inspektimit ka sjellë shkurtimin e kohës për qëndrimin e importeve nën kontrollin e doganës shqiptare. Në kthim, këto reduktime në kohë gjeneruan një rritje modeste, por reale të vlerave të importit. Për më tepër, ky studim sugjeron se ulja e normave të inspektimit ka një ndikim në vlerat e importit, duke ulur afërsisht me 0.36 % tarifën ndërkufitare. Megjithatë, kursimet që u përfituan nga ulja e kostove ishin mjaft më të mëdha, krahasuar me ato që do të përfitoheshin nga heqja e një tarife të asaj përmase. Vlerësohet se, reformat i kanë kursyer sektorit privat rreth 12 milionë dollarë amerikanë kosto për tregtinë në vitin 2012, ose 4.33 dollarë amerikanë për çdo qytetar shqiptar. Gjithashtu, normat më të ulëta të inspektimit reduktuan ndryshimet e vazhdueshme në kohën e shpenzuar në dogana dhe kjo ulje e pasigurisë u pasqyrua në rritjen e importeve.

standardeve teknike dhe procedurave. Në një raport të Bankës Botërore, ku matet perceptimi i efikasitetit të zhdoganimit, ky i fundit përcaktohet si faktori më problematik për importimin e mallrave të huaja në ekonominë e EJT-së, përveç tarifave dhe burokracia në procedura të importit.

Prandaj marrëveshja për Lehtësimin e Tregtisë paraqet mundësi për një vend si Shqipëria, pasi synon unifikimin e agjencive doganore përkatëse brenda një kuadri, i cili do t'i mundësonte shoqërive shqiptare lehtësi hyrje më të mirë në tregjet globale dhe në zinxhirët ndërkombëtarë të vlerës. Për më tepër, Shqipëria do të bëhej një vend më tërheqës për investuesit e huaj.

Si vlerësohet ecuria e Shqipërisë në efikasitetin kufitar dhe në kosto?

Raportii OECD për vitin 2015, Treguesit për Lehtësimin e Tregtisë, tregon si pikat e

forta ashtu edhe mundësitë për reformat e mëtejshme në Shqipëri. Për shembull, kur bëhet fjalë për bashkëpunimin e brendshëm të agjencisë kufitare, ecuria e Shqipërisë është vlerësuar sa 50% e praktikës më të mirë në nivel botëror. Në të njëjtën kohë, Shqipëria interpreton me 10% më mirë, për sa i takon vendimeve paraprake, krahasuar me vendin me praktikën më të mirë në botë. Studimi i OBT-së sugjeron gjithashtu se, zbatimi i MLT-së do të ketë një ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm në mbledhjen e të ardhurave qeveritare, si rrjedhojë e rritjes së vëllimeve tregtare dhe uljes së korrupsionit në kufij. Për më tepër, zbatimi i MLT-së do të ndihmojë në uljen e kostove për konsumatorët shqiptarë, duke konsideruar se kostot doganore ndikojnë në mënyrë të ndjeshme kostot e produkteve bazë sikurse janë ushqimet dhe barnat.

Vendi	Renditja sipas tregtisë jashtë kufijve (189 vende)	Koha për import: Pajtueshmëria kufitare (orë) ¹	Koha për eksport: Pajtueshmëria kufitare (orë)	Kostot për eksport: Pajtueshmëria kufitare (USD)
Shqipëri	37	9	24	181
Republika e Maqedonisë (i njëjti rajon)	26	8	49	103
Mali i Zi (i njëjti rajon)	42	23	48	158
Serbi (i njëjti rajon)	23	3	4	47
Bullgari (i njëjti grup sipas të ardhurave)	20	1	4	52
BE (krahasimi rajonal)	14	2	8	95

Burimi: Grupi i Bankës Botërore, Doing Business, Trading Across borders (2015).

WTO TRADE FACILITATION AGREEMENT (TFA)

90 OUT OF 162 WTO MEMBERS HAVE RATIFIED THE TFA SO FAR...
109 RATIFICATIONS ARE NEEDED FOR THE TFA TO ENTER INTO FORCE

- TFA RATIFICATIONS
- | | | |
|---|--------------------------|------------------|
| 1. Hong Kong, China | 16. Saint Lucia | 35. El Salvador |
| 2. Singapore | 17. Suriname | 36. Honduras |
| 3. United States | 18. Myanmar | 37. Mexico |
| 4. Mauritius | 19. Norway | 38. Peru |
| 5. Maldives | 20. Vietnam | 39. Saudi Arabia |
| 6. Japan | 21. Oman | 40. Afghanistan |
| 7. Australia | 22. Denmark | |
| 8. Switzerland | 23. Lithuania | |
| 9. Thailand and Tokelau | 24. Latvia | |
| 10. The Republic of Korea | 25. Georgia | |
| 11. Nicaragua | 26. Seychelles | |
| 12. Nepal | 27. Jamaica | |
| 13. Belize | 28. Mali | |
| 14. Switzerland | 29. Cambodia | |
| 15. Chinese Taipei | 30. Paraguay | |
| 16. Czech | 31. Turkey | |
| 17. Liechtenstein | 32. Brazil | |
| 18. Lao PDR | 33. Mexico, China | |
| 19. New Zealand | 34. United Arab Emirates | |
| 20. EU (28 countries) | 35. Tunisia | |
| 43. Thailand | 36. India | |
| 44. Togo | 37. Russia | |
| 50. The former Yugoslav Republic of Macedonia | 38. Montenegro | |
| 51. Pakistan | 39. Albania | |
| 52. Panama | 40. Kazakhstan | |
| 53. Guyana | 41. Sri Lanka | |
| 54. Costa Rica | 42. Saint Kitts | |
| 55. Grenada | 43. Madagascar | |
| | 44. Republic of Moldova | |



Shënim: Ky grafik tregon vendet të cilat kanë ratifikuar MLT deri më 31 korrik 2016.



² Pajtueshmëria Kufitare: përfshin kohën dhe koston e shoqëruar me rregullat e pajtueshmërisë, në mënyrë që transporti të kalojë kufirin e asaj ekonomie, si dhe koha dhe kostoja për përpunimin në port, ose në kufi.



Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Kriza financiare e vitit 2008, pasojat e saj, dhe mbi të gjitha, masat dhe politikat monetare, apo financiare të ndërrmara për përballimin dhe eliminimin e saj, evidentuan në frontin e parë të përpjekjeve Bankat Qendrore dhe politikat e “lehtësimit sasior”, ose “Quantitative Easing”. Përmbajtja e tyre nuk ishte gjë tjetër veçse një tip specifik politikash monetare të cilësuar si “jo konvencionale”, të ndërrmara në situata dhe kushte ekonomike e financiare të vështira në kontekstin e efekteve të krizës ekonomike e financiare, që kalonin vende të veçanta apo grupime vendesh siç është rasti i eurozonës. P.sh., në rastin e eurozonës “lehtësimi sasior” nënkupton një blerje masive nga ana e BQE-së të aktiveve dhe obligacioneve shtetërore në një shumë prej 1.100 miliardë euro, në periudhën mars 2015 – shtator 2016, pra 60 miliardë euro çdo muaj. Vetëm gjatë periudhës 2009-2010, Banka e Anglisë

“Lehtësimi sasior” dhe deflacioni Pikëpyetjet e Bankave Qendrore

Konteksti i normave të ulta të interesit dhe masat rregullatore që synojnë stabilitetin financiar në kuadrin e Bazel III apo unionit bankar evropian po ushtrojnë ndikime të konsiderueshme në aspektin e ndërmjetësimit financiar dhe dobësimit të mundësisë së politikave monetare për realizimin e objektivave të tyre tradicionale.

ndërhyri dhe bleu në treg mbi 200 miliardë paund aktive të institucioneve financiare, obligacione apo borxh publik. Në SHBA, që nga viti 2008, nga ana e FED-it janë ndërmarrë disa herë programe të lehtësimit sasior, që e kanë kaluar tashmë shifrën e mbi 1.000 miliardë dollarëve.

Termi “jo konvencional” buron nga fakti se në këtë rast bankat qendrore nuk përdorin apo nuk janë në gjendje të përdorin instrumentin e tyre tradicional të politikës monetare: “normën bazë të interesit”, që është zero apo afër zeros, mbi bazën e të cilës përcaktohen dhe normat e interesit në tregun monetar ndërbankar, rezervat e detyrueshme të bankave tregtare në bankat qendrore, operacionet e tregut të hapur, etj. Krejt ndryshe, “operacionet jo-konvencionale”, në kuadrin e lehtësimit sasior, konsistojnë në një zgjerim të masës monetare dhe bilancit të bankave qendrore nëpërmjet blerjes së aktiveve si: obligacionet, borxhet me rrezik, hua me probleme, tituj hipotekarë, produkte derivate toksike, etj. Duke i “pastruar” bankat tregtare nga produktet problematike dhe ofruar masivisht monedhë me kosto thuajse zero, bankave ju krijohen mundësi të japin më shumë hua me norma të ulta

interesi, e në këtë mënyrë, të stimulojnë investimet, konsumin, rritjen ekonomike, të dekurajojnë kursimet dhe depozitat, etj..

Në historinë e bankave qendrore dhe sistemit bankar në përgjithësi, një politikë apo masë e tillë nuk konsiderohet aspak si diçka e zakonshme, madje deri në vitet ‘90 cilësohej thjesht si një mundësi teorike me mundësi pothuajse zero në praktikën e politikave monetare. Të paktën në 60-70



Institucionet dhe veprimtaritë me natyrë jo-bankare, të specializuara në segmente të caktuara të tregjeve monetare e financiare tradicionale, po bëhen mjaft konkurruese e tërheqëse për paranë dhe kapitalet, por nga ana tjetër, ky ndryshim strukturor i tregjeve financiare po dobëson ndikimin e politikave monetare dhe “sinjaleve” të tyre, si dhe po shton ekspozimin e përgjithshëm ndaj rrezikut, sidomos atë sektorial.



Kredi Hipotekore



Interes fiks **3.9%** në Eur për vitin e parë
Nga **5%** interes për periudhën e mbetur
Shpenzime **0** pas vitit të parë

vitet e fundit, bankat qendrore të vendeve të zhvilluara nuk kanë mbajtur norma bazë interesi për monedhat e tyre në nivele kaq minimale afër zeros. Gati shtatë dekada pas “depressionit të madh” të viteve ‘30, normat bazë të interesit afër zeros ishin zhdukur nga kujtesa duke menduar se ato tashmë i përkisnin një historie të shkuar. Studimet e para mbi eficientësinë e politikave monetare tradicionale në situata të vështira ekonomike e financiare, sidomos ato deflacioniste, u formuluan nga Keynes, pikërisht në vitet 1930-të. Pas refleksioneve të Keynes dhe aplikimit për herë të parë në këto vite të politikave të lehtësimit sasior dhe përpunimit të teorisë së mekanizmave të transmetimit të këtyre politikave në ekonomi, në historinë dhe dinamikën e mëvonshme të politikave monetare nuk ka pasur zhvillime të reja. Për më tepër, edhe në kuadrin e kontekstit mjaft specifik që njohu Japonia në vitet 1990 në kuadrin e “dekadës së humbur”, ideja që politika monetare mund ta humbte eficientësinë dhe rolin e saj tradicional ishte e paimagjinueshme.

Sinjalet e para për këtë shqetësim u dhanë nga ekonomisti Paul Krugman, që analizoi ndikimin e politikave monetare në kontekstin e interesave shumë të ulta të normave bazë të interesit, duke hapur njëkohësisht edhe debatin mbi ekzistencën e fenomenit të “kurthit të likuiditetit”. Kjo u ndoq nga masat e para me natyrë “jo konvencionale”, të zbatuara nga Banka Qendrore e Japonisë në vitet 2001-2006, që përtej të qenit rasti i parë, ishin dhe sinjali i fillimit në shkallë të gjerë i një “kohe të re” të zbatimit të politikave të lehtësimit sasior në shkallë të gjerë. Shpërthimi i krizës financiare globale në vitin 2008 shënoi kthesën historike drejt politikave monetare jo-konvencionale, të konceptuara dhe zbatuar në një larmi të madhe formash nga FED, BQE, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë, etj. Benjamin M. Friedman, i Universitetit të Harvardit nënvizon se “në këtë situatë specifike, bankat qendrore po e vënë theksin gjithnjë e më shumë te stabilizimi i tregjeve financiare, ndërkohë që blerja e aktiveve po zëvendëson gradualisht përdorimin e instrumentit të normës bazë të interesit. Në kushtet e masave jo-konvencionale,

teoria sasimore e parasë duket e tejkaluar, ose më e pakta, jo efciente”.

Aktualisht, gati tetë vite nga fillimi i kësaj “epoke të re të politikave monetare” që korrespondon me shpërthimin e krizës financiare, fundi i saj që nënkupton dhe fundin e vetë masave jo-konvencionale, duket ende i largët. Hapat dhe masat e ndërmarra nga eurozona, FED-i, Banka e Anglisë, Banka e Japonisë dhe shumë banka të tjera qendrore, duken ende “të ndrojtura e delikate”, çka pasqyron faktin që pohimi se kriza ka kaluar plotësisht është ende larg. Në zonën euro, BQE vijon të jetë larg objektivit të saj të nivelit të inflacionit mesatar prej 2%, ndërkohë që inflacioni lëkundet në intervalin 0.3 – 0.8%. Edhe FED, pas një politike monetare me norma interesi bazë thujse zero që prej vitit 2008, në fund të vitit 2015 dha një sinjal të ndrojtur ndryshimi, duke kaluar në një përqindje interesi bazë për dollarin në masën 0.25 – 0.50%, vendim që u perceptua dhe analizua nën optikën e fillimit të “braktisjes së masave të tipit quantitative easing” dhe orientimit drejt një kahu të kundërt të politikës monetare.

Lidhur me efektin dhe arsyet e ndërrmarjes së politikave të lehtësimit sasior, debatet dhe analizat aktuale janë përqendruar në disa akse, apo pista reflektimi: Cilat ishin shkaqet e vërteta të uljes drastike deri në nivelin 0% të normave bazë të interesit? A ishte kjo përgjigja më e mirë dhe më efciente e autoriteteve monetare? Cilat ishin shkaqet reale të çekuilibrave të mëdha financiare e monetare që u vërejtën në kuadrin e krizës financiare globale të vitit 2008? Cila është metoda më e mirë për administratorët e aktiveve financiare, sistemi i kapitalizimit apo sistemi i rishpërndarjes? Kur është periudha optimale për të filluar tërheqjen nga politikat e lehtësimit sasior dhe bërë bilancin e efekteve reale apo të synuara të tyre? A po krijohet rivaliteti i panevojshëm ndërmjet politikave monetare dhe atyre makroprudenciale? Dhe së fundi, në kushtet e një tregu financiar dhe ekonomie gjithnjë e më të globalizuara, a cojnë politikat e lehtësimit sasior të disa vendeve drejt një “luftë monedhash”?

Debatet fillojnë me identifikimin

e shkaqeve thelbësore të çekuilibrave në ekonominë reale. Gati 8 vite pas shpërthimit të krizës financiare, megjithë përpjekjet monetare të jashtëzakonshme, ende shumica e ekonomive të vendeve të ndryshme nuk ka arritur nivelet e para-krizës, gjë që dëshmon për ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme strukturore që i shkaktojnë ato, të tilla si: efektet frenuese, të shkaktuara nga fluckat imobiliare, zhvillimi i shpejtë i teknologjive të informacionit që provokon papunësi, ndryshimet demografike veçanërisht plakja e popullsisë, etj.. Këto arsye kanë dhënë ndikim negativ në kërkesën globale, që është bërë më pak e ndjeshme ndaj masave stimuluese me karakter monetar e financiar të bankave qendrore. Ekspertët mendojnë se një interpretim i ri po del në skenë: sidomos vendet e zhvilluara dhe ato me ekonomi në zhvillim, po përballen me rritje ekonomike të ulët dhe stanjacion afatgjatë, si pasojë e “ekonomive strukturalisht të dobëta përballë rritjes ekonomike, si pasojë e kërkesës së dobët globale, zvogëlimit të fuqisë punëtore dhe pafuqisë së progresit teknik, që të kompesojë uljen e numrit dhe produktivitetit të fuqisë punëtore. Duket se “vullneti për kursime është strukturalisht superior ndaj dëshirës dhe mundësisë për investime efciente – ekuilibër që po prirret të rregullohet me instrumentin e përqindjeve negative të interesit, si element që mund të ekuilibrojë kërkesën dhe ofertën e likuiditeteve”.

Një përfundim që po gjen mbështetje të gjerë është se “situata aktuale pasqyron fundin e një modeli rritjeje ekonomike dhe financimi të mënyrave të prodhimit”. Shqetësim kryesor po bëhet “koherenca sistemike”, “rreziqet e reja të lidhura me dobësimin e fuqisë së kapitaleve” dhe “përqindjet e ulta të interesit që frenojnë investimet e kapitalit e për pasojë punësimin, produktivitetin dhe nivelin e pagave”. Dobësitë e sektorit monetar dhe financiar janë pjesë e këtij skenari, duke kërkuar që këta sektorë të “jetësojnë një perspektivë afat-gjatë që përshtatet me këtë revolucion të ri industrial e teknologjik që po ndodh në botë, përshtatje që kalon nëpërmjet një ristrukturimi real të gjithë sektorit bankar, veçanërisht rolit dhe

instrumenteve të bankave qëndrore”. Në këtë këndvështrim, normat negative të interesit mund të ndikojnë në frenimin drejt një spiraleje deflacioniste, por politikat monetare po futen në terrene të panjohura me pikëpyetje të mëdha: deri ku mund të shkohet me masat jo-konvencionale? A do shkohet drejt një mbështetje të drejtpërdrejtë të konsumit, nëpërmjet “parave nga helikopteri” të Milton Friedman-t?, A munden bankat qendrore të financojnë drejtpërdrejt projekte të mëdha publike?

Element i rëndësishëm në kuadrin e diskutimeve mbi rolin e politikave monetare është dhe raporti midis “përqindjeve të ulëta të interesit dhe ndërmjetësimit financiar”. Politikat jo-konvencionale po shkaktojnë dhe një seri të ashtuquajtur “efekte anësore ose atipike” që pasqyrohen në tregjet afatgjata të kapitaleve, rishpërndarjen e aktiveve nga sektori privat drejt bankave qendrore, krijimi i disa prirjeve të qëndrueshme afatgjata, mjaft të vështira për t’u ndryshuar, kursimet afatgjata private po orientohen drejt shërbimeve që kanë të bëjnë me banesat, shëndetin, sigurimet, etj., në vend që të orientohen drejt investimeve

produktive. Konteksti i normave të ulta të interesit dhe masat rregullatore që synojnë stabilitetin financiar në kuadrin e Bazel III apo unionit bankar evropian po ushtrojnë ndikime të konsiderueshme në aspektin e ndërmjetësimit financiar dhe dobësimit të mundësisë së politikave monetare për realizimin e objektivave të tyre tradicionale. Të dhënat e referuara nga studiues të fushës bankare evidentojnë faktin se, institucionet dhe veprimtaritë me natyrë jo-bankare, që ushtrojnë funksione ndërmjetësimi midis kursimeve dhe investimeve, janë në progres të vazhdueshëm. Këto institucione të specializuara në segmente të caktuara të tregjeve monetare e financiare tradicionale po bëhen mjaft konkurruese e tërheqëse për paranë dhe kapitalet, por nga ana tjetër, ky ndryshim strukturor i tregjeve financiare po dobëson ndikimin e politikave monetare dhe “sinjaleve” të tyre, si dhe po shton ekspozimin e përgjithshëm ndaj rrezikut, sidomos atë sektorial.

Së fundi, si pasojë një integrimi global gjithnjë e më të madh të tregjeve financiare e monetare, politikat monetare të FED-it, BQE-së, Bankës së Anglisë, Bankës së

Japonisë, Bankës së Kinës, etj., kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në tregjet e parasë të shumë vendeve të tjera të botës, duke çuar drejt asaj që cilësohet si “norma reale botërore e interesit”. Tashmë, bankat qëndrore, sidomos ato të vendeve më të zhvilluara reagojnë në përputhje me forcat strukturore të ekonomisë botërore dhe jo thjesht me konjunkturën e ekonomive të tyre kombëtare, ndërkohë që interesat e tyre transmetohen si “detyrim” për vendet e tjera më të vogla, më të pazhvilluara, apo vendet konkurrenente tregtare. Politikat specifike të lehtësimit sasior dhe tërësia e politikave jo-konvencionale çon në mënyrë të pashmangshme drejt një “lufte monedhash” ndërmjet SHBA-së, Kinës, Eurozonës, Japonisë, Britanisë së Madhe, etj. Nga kjo pikëpamje, politikat e normave të interesit të bankave qëndrore përcaktojnë dhe flukset e kapitaleve dhe yield-in e tyre në tregje të ndryshme, ashtu siç “ndihmojnë” në shpërndarjen e efekteve negative të fluckave financiare të vendeve të veçanta në gjithë rrjetin e tregjeve financiare globale. Pikëpyetjet mbi rolin dhe politikat e bankave qëndrore në këtë kontekst të ri mjaft kompleks vazhdojnë.



Përgjegjshmëria Sociale



Mbështeti Panairin dhe Konkursin Kombëtar të Shoqërive të Nxënësve, organizuar nga Junior Achievement, më 04 maj 2016, në mjediset e Aeroportit “Nënë Tereza”. Rreth 138 nxënës maturantë nga gjithë vendi, prezantuan produktet apo shërbimet që realizuan në kuadër të kësaj veprimtarie.



Organizoi më 22 maj 2016, Ditën e Vullnetarizimit të Alpha Bank Albania, ku më shumë se 100 punonjës të bankës, pastruan gjire të ndryshme në Kepin e Rodonit.

Më 4-5 qershor 2016, më pjesëmarrjen e më shumë se 100 punonjësve të bankës, u realizua mbjella e 3,100 pishave të zeza, duke synuar ripërtëritjen e florës dhe faunës natyrale në Parkun Kombëtar të Lurës.



Më 21 qershor 2016, në bashkëpunim dhe me Kryqin e Kuq Shqiptar, organizoi dhurimin e gjakut nga punonjësit e bankës për fëmijët me talasemi.



Mbështeti projektin “Muaji i Qyteteve të Gjelbra”, iniciuar nga Green Line Albania, me qëllim promovimin e konceptit të qyteteve të gjelbra dhe të qëndrueshme si edhe ndërgjegjësimin e qytetareve për mirëmbajtjen e qyteteve të pastra dhe në harmoni të plotë me natyrën.



Mbështeti veprimtarinë e organizuar nga Rezidenca Studentore Universitare “Konkursi i Pikturës”, duke mundësuar për fituesit e tre vendeve të para rezidencë falas për vitin e ardhshëm akademik 2016-2017.

Përqafoi nismën: “Fushata e mbledhjes së ndihmave për fëmijët jetimë në komunitet” dhe në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, Dega Tiranë, mbledhi ndihma për 200 fëmijët jetimë në komunitet.



Mbështeti organizimin e edicionit të tretë të Javës së Inovacionit. Kjo veprimtari kishte në fokus prezantimin dhe vlerësimin e situatës së ekosistemit të inovacionit në Shqipëri.



U vlerësua nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, me një falënderim të veçantë për kontributin në mbështetje të komunitetit më të rëndësishëm, që janë fëmijët, duke u bërë pjesë e nismës “Adopto një Çerdhe”.



Mbështeti konkursin kombëtar “Ide të Gjelbra 2016”, i cili synon të mbështesë nisma biznesi që promovojnë përfshirjen sociale, integrimin, punësimin dhe zhvillimin ekonomik lokal, nëpërmjet një qasjeje miqësore ndaj mjedisit.

Mbështeti Institucionin “Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve”, duke i dhuruar një automjet të tipit frigorifer, për shpërndarjen e ushqimit të fëmijëve në çerdhet e Tiranës.

Mbështeti veprimtarinë: “Shpresë për Shqipëri”, që është një formë ndërgjegjësimi për të treguar dashuri për të gjithë fëmijët apo të rriturit që janë me talasemi dhe kanë nevojë për gjak.

Mbështeti “Konkursin Kombëtar të Sipërmarrësve të së Nesërmes dhe Juristëve të së Nesërmes”, të organizuar nga Tirana Business University.



PRODUKTE TË OFRUARA NGA INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK



ALL [IN] ONE PLAN - PAY - SAVE

TRANSPARENT SI KARTA JUAJ

- Menaxhim të llogarisë tuaj, Planifikim - Pagesa - Kursime.
- Kryeni kurdo dhe kudo veprime bankare të sigurta.
- Kërkoni gjendjen e parave me sms dhe llogarisë me e-mail.
- Elimino Cash-in, përdoreni kartën në ATM - POS - ONLINE.
- Paguani shpejt, lehtë, të mbrojtur nga PayPal.



PA GARANTOR

KREDI KONSUMATORE

- NORMA INTERESI TË PANDRYSHUESHME**
përgjatë të gjithë ciklit të kredisë, duke filluar nga 9% në lekë për klientë pagamarrës dhe nga 10% për jo pagamarrës.
- APROVIM I MENJËHERSHËM**
dhe ju do të mund të merrni kredinë shpejt dhe lehtë.
- VËRTETONI QË MERRNI NJË PAGË**
nuk është kusht që pagën ta merrni në bankën tonë.



MIRATIM I MENJËHERSHËM

KREDI BIZNES I VOGËL

- DERI NË VLERËN 1 MILION LEKË**
 - NUK NEVOJITET KOLATERAL
 - APROVIM DERI NË TRE DITË
- DERI NË VLERËN 5 MILION LEKË**
 - NUK NEVOJITET KOLATERAL
 - AFAT SHLYERJE DERI NË 84 MUAJ
 - KONSIDEROHET ÇDO TIP KOLATERALI

WWW.ICB.AL

04 22 56 254



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK
rëndësi kanë vlerat





Sponsorizoi Maratonën “TiRun” që u zhvillua më datë 02 prill 2016 në Ditën Ndërkombëtare të Autizimit, organizuar nga Shoqatat “Fëmijët Shqiptarë” dhe “Autizmi flet Shqip”. Gjithashtu, punonjësit bankës kontribuan në blerjen e bluzave, ndërkohë që pati një pjesëmarrje të gjerë në maratonë.



Zhvilloi seancën e parë të dhurimit të gjakut për vitin 2016, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, në mjediset e bankës, përkatësisht në datë 06 prill 2016.



Në bashkëpunim me shkollën ndërkombëtare “World Academy of Tirana”, mirëpriti më 09 qershor 2016 në mjediset e saj, rreth 22 fëmijë nga kjo shkollë. Në program u përfshi edhe një vizitë në Muzeun e Bankës së Shqipërisë.



Në bashkëpunim me institucionet arsimore në vend, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës në shërbim të profesionistëve të ardhshëm, organizoi vizitën e një grupi prej 13 studentësh të Universitetit Jopublik “Luarasi”, Dega “Financë Bankë”, në Zyrat Qendrore të bankës, gjatë muajit Prill; si dhe vizitën studimore në Departamentin e Auditit të bankës, ku morën pjesë rreth 25 studentë të Universitetit të New York-ut në Tiranë.



Mori pjesë në Panairin e Karrierës, të organizuar me 26 Prill në Universitetin Jo – Publik “Epoka” si edhe në Panairin e Punës dhe Karrierës, të organizuar në 17 maj në Universitetin Jo – Publik “UET”.

Organizoi në 12 dhe 13 maj 2016 pranë dy degëve të saj, nismën e Dhurimit Vullnetar të Gjaktit, për të gjashtin vit radhazi. Grupi i Dhuruesve Vullnetarë të Gjaktit të Grupit Intesa Sanpaolo festoi në 28 maj në ndërtesën e Intesa Sanpaolo në Torino 50 vjetorin e krijimit, ku morën pjesë dhe përfaqësues të grupit të dhuruesve nga filiali i bankës në Shqipëri.



Ndërmori një fushatë ndërgjegjësimi për shmangien e përdorimit të duhanit përgjatë gjithë ditës, për t’u ndërgjegjësuar lidhur me pasojat negative të tij në jetën dhe shëndetin e të gjithëve.

Për 1 Qershorin, Ditën e Fëmijëve, organizoi një thirrje të brendshme drejtuar të

gjithë kolegëve për të ndihmuar me: mbledhje fondesh në llogari për Fondacionin “Down Syndrome Albania”, për organizimin e kampit veror për nënat dhe fëmijët e qendrës; Mbledhje fondesh në llogari dhe veshmbathje, për të ndihmuar fëmijët jetimë; Ndihmë me pako ushqimore, të përgatitura nga vetë punonjësit, për personat me aftësi të kufizuara, organizuar nga Shoqata Vullnetare për Zhvillim e Solidaritet.



Në kuadër të Ditës Botërore të Mjedisit, në 5 qershor 2016, organizoi një fushatë ndërgjegjësimi ndaj punonjësve e klientëve të saj, përmes e-maileve informuese, imazheve në ATM dhe kartolinave në fund të shkëmbimit të postës elektronike (e-mail footer).



Sponsorizoi çmimet e fituesve të “Festivalit të 49-të të Këngës për Fëmijë”, organizuar nga Bashkia Korçë dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve: “Mihal Grameno”.



Dhuroi pajisje zyre në spitalet publike të Gjirokastrës dhe Pogradecit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e këtyre qyteteve.





Mblodhi së bashku rreth 500 NMV për zgjerimin e bashkëpunimit rajonal, të cilat morën pjesë në veprimtarinë e organizuar në Selanik, Greqi. Nga ProCredit Shqipëri morën pjesë rreth 30 biznese që operojnë në sektorë të ndryshëm.



Organizoi një aksion të përbashkët për pastrimin e mjedisit nga mbeturinat me pjesëmarrjen e rreth 100 punonjësve. Ky aksion, që përkoi dhe me hapjen e sezonit turistik, u shtri në disa zona, si: Plazhi i Shëngjinit në Lezhë dhe zona turistike e qytetit të Korçës.



Mbështeti, për të katërtin vit radhazi, veprimtarinë Eco-Fashion Show, që u zhvillua në 4 qershor 2016. Si çdo vit, mesazhi që përcjell kjo veprimtari është: Redukto - Riciklo - Ripërdor - Rikrijo.



Mbështet prej shumë vitesh Shoqatën e Gjimnastikës Artistike Aerobike, e cila me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Jetimëve, organizoi edhe këtë vit veprimtarinë: “Së bashku si një”.

Përkrahu nismën e Bashkisë Tiranë, në bashkëpunim me Shoqatën “Art, Kulturë, Integrim”, në realizimin e projektit “Qyteti i Luxesve”. Ky projekt lidhet me pasurimin me libra të bibliotekave funksionale të lagjeve në Tiranë.

Mbështeti edhe këtë vit realizimin e edicionit të katërt të “Albanian ICT Awards”, i cili shpalli gjatë mbrëmjes Gala të mbajtur në datë 29 prill 2016 fituesit e garës mbarëkombëtare në sektorin e teknologjisë së informacionit.

Mbështeti nismën e Drejtorisë Arsimore Durrës për pajisjen me kamera sigurie të shkollave të qytetit. Projekti është zbatuar në 7 prej këtyre shkollave dhe do të vazhdojë edhe më tej, derisa të pajisen të gjitha shkollat e qytetit.



Më 8 – 9 maj 2016, në bashkëpunim me Fondacionin “Culture Europe”, organizoi Koncertin e Europës.



Nga data 20 – 22 maj 2016 mori pjesë si sponsor i përgjithshëm në edicionin e 5-të “Startup live Tirana”, njëveprimtari që mbledh së bashku studentë të angazhuar në ekipe, duke mundësuar dhe zhvilluar ide të reja, me qëllimin për të sjellë risi në tregun Shqiptar.



Bashkëpunoi me Junior Achievement në veprimtarinë: “Drejtues për një ditë”. Një nga maturantët e përzgjedhur nga kjo organizatë kaloi ditën në mjediset e zyrave qendrore të bankës. Në fund të praktikës u shpërndanë certifikata për studentët pjesëmarrës.



Së bashku me partnerë të saj, organizoi më datën 9 maj 2016, në sheshin “Nënë Tereza”, veprimtarinë: “EU-TRANZIT” me rastin e Ditës së Europës. I konceptuar si një Aeroport me 4 terminale përkatësisht: Agro-Turizëm, Art-Kulturë, Teknologji-Inovacion, Komunikim dhe Perceptim, sheshi u kthye në një hapësirë ku u promovuan potencialet

dhe vlerat më të mira që ka Shqipëria. Në qendër të sheshit u vendos inkubatori i biznesit, ku 10 të rinj prezantuan idetë e tyre si sipërmarrës. Pesë prej këtyre projekteve u shpallën fitues dhe do të mbështeten financiarisht, si pionierë të integritimit dhe pionierë në biznes.



Në bashkëpunim me Fondacionin “Down Syndrome Albania”, mbështeti festën e fëmijëve, si edhe 2 vjetorin e “Qendrës së Arritjeve dhe Zhvillimit” të Fondacionit “Down Syndrome Albania”. Gjithashtu, po në këtë ditë, mbështeti Bashkinë Korçë në organizimet e festës së 1 Qershorit, për fëmijët e këtij qyteti.

Mbështeti në Gjirokastër fëmijët e familjeve në nevojë, duke përgatitur paketa ushqimore në ndihmë tyre.



Përkrahu maratonën “Run for Autism”. Staf i bankës mori pjesë në maratonën e organizuar në Tiranë, në mbështetje të fëmijëve dhe familjeve me fëmijë autikë.



Mbështeti fushatën ndërgjegjësuese #UnëMbrojFëmijët#. Staf i përcaktoi ditën e premte për veshjen e bluzave me logon e kësaj fushate dhe komunikoi me klientët për rëndësinë e reagimit dhe denoncimit të çdo forme kërcënimi, apo abuzimi mbi fëmijët, në Aplikacionin: Raporto! Shpëto! Ose telefono 116, 111, 129!

Dhuroi pajisje zyre (fotokopje dhe printer) në Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli”, si dhe shërbim të dedikuar për institucionin nga stafi i degës së bankës pranë Gardës së Republikës.

Nënshkroi marrëveshjen e sponsorizimit për periudhën 2016-2018, me Federatën Shqiptare të Futbollit.



Prof. Asoc. Dr. Arbi AGALLIU

Përgjegjës i Departamentit të Financës & Ekonomiksit
UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

“Helicopter Drops” apo “Paratë nga helikopteri” është një mjet hipotetik, i pazakontë i politikës monetare, që përfshin shtypjen e parasë në shuma të mëdha dhe më pas shpërndarjen e tyre në publik, për të stimuluar ekonominë e një vendi. Kryesisht është një metaforë për masa jo-konvencionale, të cilat përdoren për të ristartuar apo për të ndihmuar ekonominë e një vendi gjatë periudhave të vështira nëpër të cilat mund të kalojë, si për shembull një krizë ekonomike e shoqëruar me deflacion¹.

Edhe pse ide apo koncepte të tilla të ngjashme janë diskutuar më parë nga ekonomistë të ndryshëm, shprehja “Paratë nga helikopteri” është përdorur për herë të parë në një ese të shkruar në vitin 1969 nga ekonomisti amerikan, nobelisti Milton Friedman, duke supozuar në tonet e imagjinatës printimin e parave dhe hedhjen e tyre nga helikopteri. Ai e përdor fjalën helikopter si një metaforë për të

Paratë nga helikopteri



“Paratë nga helikopteri” është propozuar si një alternativë për të krijuar stabilitet në momentin kur normat e interesit janë afër zeros dhe ekonomia shfaq shenja të theksuara dobësie, apo hyn në recesion.



argumentuar se institucionet përgjegjëse të cilat kanë të drejtën e emetimit të parasë mund të krijojnë inflacion, duke shtypur para’ aq shumë sa të nxisin rritjen e konsumit, duke çuar më pas në një efekt pozitiv në zinxhirin ekonomik me qëllimin final rritjen ekonomike. “Paratë nga helikopteri” ai i shpreh si një opsion të mundshëm për çdo vend i cili ndodhet në “luftë” me deflacionin dhe me rritjen e ngadaltë të ekonomisë.

Nobelisti Friedman në punimin e tij “Sasia optimale e parasë” shprehet se: “Le të supozojmë që një ditë një helikopter do të fluturojë mbi komunitet dhe do të na hedhi 1.000\$. Gjithashtu, le të supozojmë më tej se të gjithë janë të bindur që kjo është një ngjarje e veçantë dhe se kjo ngjarje nuk do të përsëritet më.” Supozimin e dytë Friedman e bën për të evidentuar faktin se ky instrument nuk mund të përdoret në mënyrë të vazhdueshme, por rrallë, ose vetëm një herë e pikërisht atëherë kur ekonomia është në recesion dhe shpresat për rimëkëmbje janë të venitura.

Pavarësisht se ky term, për herë të parë është përmendur nga z. Milton Friedman, mund të themi se popullaritetin e mori gjatë fjalimit të guvernatorit të Rezervës Federale, z. Ben Bernanke, në nëntor të

vitit 2002. Gjatë këtij fjalimi të mbajtur në Klubin Kombëtar të Ekonomistëve, z. Bernanke e përcaktoi deflacionin si “një efekt anësor i një kolapsi në kërkesën agregate, ose si një reduktim aq të rëndë të shpenzimeve të konsumatorit sa që e detyron prodhuesin të ulë në mënyrë të vazhdueshme çmimet, në mënyrë që të gjejë blerës të produkteve të tij”.

“Paratë nga helikopteri” është propozuar si një alternativë për të krijuar stabilitet në momentin kur normat e interesit janë afër zeros dhe ekonomia shfaq shenja të theksuara dobësie, apo hyn në recesion. Kur përdoret ky term, ekonomistët i referohen dy politikave të cilat janë të ndryshme nga njëra - tjetra. Grupi i parë i politikave thekson monetizimin e përhershëm të deficitit buxhetor, ndërsa grupi i dytë përfshin bankën qendrore dhe thekson se duhen bërë transferta të drejtpërdrejta në sektorin privat nga ana e bankës qendrore, pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të autoriteteve fiskale. Ky lloji instrumenti quhet ndryshe edhe dividendi i qytetarëve. Të shumta janë qëndrimet dhe teoritë pro dhe kundër këtij instrumenti monetar. Disa kohë më parë z. Mario Draghi, President i Bankës Qendrore Europiane

¹ Një situatë e ngjashme kjo me situatën akutale që po kalon vendi ynë në këto momente. Ky përkufizim është marrë nga www.investopedia.com.

FLUTURO DREJT ENDRRAVE ME KREDINE 24 ORE

NJE BOTE MUNDESISH REALE



INTESA SANPAOLO BANK

PERFITONI KREDINE E SHPEJTE KONSUMATORE
ME APROVIM BRENDA 24 OREVE
PA GARANTOR DHE PA KOLATERAL

0 KOMISION PER PAGESE TE PARAKOHSHME
O KOMISION MIREMBAJTJE PER LLOGARINE E KREDISE
NJOFTIM ME SMS PER PAGESEN E KESTEVE MUJORE



CALL CENTER
08006000 (Falas nga Albtelecom & Eagle)
+355 4 2276000
+355 692080903

www.intesasanpaolobank.al

BANK OF INTESA SANPAOLO GROUP

INTESA  SANPAOLO



vuri në dukje se “Paratë nga helikopteri” mund të kryhet nga të gjitha bankat qendrore të vendeve të ndryshme, si një mjet për të ndihmuar ekonominë të dalë nga recesioni, apo rënia ekonomike. Megjithatë, ai ngriti pyetjen: Nëse dhe kur ky instrument monetar është i përshtatshëm për t’u zbatuar? Nga ana tjetër, z. Richard Clarida, ekonomist i njohur në Columbia University, parashikon se ekonomia moderne do të shohë hedhjen e parave nga helikopteri pas 5 apo maksimumi 10 viteve të ardhshme.

Një tjetër këndvështrim vjen nga ekonomisti Simon Wren-Lewis. Ai shprehet se do të ishte më mirë që të shtypeshin para’ dhe të shpërndareshin te konsumatorët, të cilët do t’i shpenzonin ato për veten e tyre, në vend që të përdroreshin për të blerë borxhin qeveritar, i cili mund të reduktonte normën e interesit në periudhë afatgjatë e më pas, do kishte ndikimin e tij në stimulimin e ekonomisë. Sipas tij, rruga e dytë është provuar dhe shpeshherë ka treguar që nuk ka qenë e suksesshme. Kështu që: Pse të mos provojmë rrugën e parë?

Në konceptin e “Parave nga helikopteri” shumë e diskutueshme është dhe masa e përdorur e saj. Pra, sa e madhe apo e vogël do të jetë sasia e parave të shtypura, apo kohëzgjatja e saj. Një stimul modest mund të heqë apo reduktojë inflacionin. Mendohet se një balancë e mirë e sasisë së emtuar dhe kohëzgjatjes së saj mund të çojë gjithashtu në një qëndrueshmëri

të tregjeve të brendshme dhe një stabilitet makroekonomik. Nga ana tjetër, skeptikët dalin me teorinë e të shpenzuarit të këtyre parave “jo në mënyrën e duhur”.

Kjo do të thotë se, pavarësisht shpenzimit të këtyre parave në tregjet e brendshme të një vendi, mënyra dhe tregu ku shpenzohen ka të bëjë së tepërmi me ndikimin që do të ketë në rritjen ekonomike të vendit. Për më tepër, konsumatorët mund të prirën që t’i kursejnë këto para’, duke bërë që stimuli të jetë me pak efektiv. Gjithashtu, ekziston edhe rreziku që një shumë e këtyre parave mund të shpenzohet për importim, duke ndikuar kështu pozitivisht në ekonominë e një vendi tjetër.

Kohët e fundit është artikulluar se edhe ekonomia shqiptare mund të ketë nevojë për “Para’ nga helikopteri”. Në Shqipëri duket qartë që ka shumë hapësira veprimi, të cilat mund të rregullojnë situatën ekonomike dhe nuk është e nevojshme marrja e një hapi të tillë, sikurse është shtimi i ofertës monetare sipas parimit të “Parave nga helikopteri”. Kështu, duhet detyrimisht më parë të përdoren të gjitha mundësitë për sigurimin e stabilitetit makroekonomik dhe për nxitjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe më pas, nëse nuk ka asnjë alternativë tjetër, mund të hidhen sytë nga “Paratë nga helikopteri”.

Shqipëria realisht mund të plotësojë kushtet për një akt si “Paratë nga helikopteri” dhe kjo politikë mund të ndikojë

pozitivisht në rritjen e konsumit nga ana e konsumatorëve e si pasojë, në rritjen e kërkesës agregate, rritjen e inflacionit, duke shmangur deflacionin si një element tepër negativ në zhvillimin ekonomik, si dhe në një shpërndarje më të mirë të të ardhurave, sidomos të atij grupi, i cili në mënyrë të “padrejtë” preket nga paketa fiskale. Por nga ana tjetër, përdorimi i kësaj praktike bie në kundërshtim me parimet e tregut të lirë, duke bërë që Banka Qendrore të marrë tashmë një pozicion jo normal në raport me sistemin privat bankar.

Gjithashtu, Banka Qendrore si pasojë e kësaj politike mund të humbasë ndikimin që ka në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik nëpërmjet politikës monetare që ajo bën. Së dyti me këtë masë mund të kalohet në krahun tjetër, pra në një rritje të pakontrolluar të inflacionit, e për më tepër, një hap i tillë do të nxisë konsumatorin të mendojë që zgjidhjen gjithmonë do ta gjejë nga “shteti”, duke i bërë ata të mendojnë gjithmonë e më pak lidhur me miradministrimin e financave të tyre.

Në këtë kontekst, Shqipëria aktualisht nuk e ka të nevojshme të përdorë “Paratë nga helikopteri”, por ka mundësi të rregullojë stabilitetin makroekonomik me elementet e tjerë të politikës fiskale dhe monetare, ku së pari duhet që të dy këto politika t’i kthejë në harmoni dhe bashkërendim me njëra-tjetrën, për të pasur rezultat optimal.

BANKINGU DIGJITAL NË SHQIPËRI

Në datë 25 maj 2016, u zhvillua konferenca me temë “Bankingu digjital në Shqipëri”, organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave. Qëllimi i organizimit të kësaj konference është promovimi i teknologjive të reja që sektori bankar përdor në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve bankare për qytetarët shqiptarë.

Në fjalën e hapjes, Kryetari i Shoqatës së Bankave, z. Christian Canacaris theksoi se teknologjia dhe konsumatorët kanë kontribuar në vizionin e bankave, që këto të fundit të rimendojnë mënyrën në të cilën ato operojnë. 12 nga 16 banka të cilat operojnë në vend, ofrojnë internet banking, 7 nga 16 ofrojnë mobile banking dhe 3 banka ofrojnë e-commerce. Gjatë pesë viteve të fundit (2011 - 2015) industria bankare ka investuar 65 milionë euro në infrastrukturë dhe shërbime të teknologjisë së informacionit. Këtë vit është planifikuar të investohen 16 milionë euro.

Kjo konferencë ishte e organizuar në tre panele kryesore:

Paneli i parë u drejtua nga Zëvendësgubernatorja e Parë e Bankës së Shqipërisë, zj. Elisabeta Gjoni, njëkohësisht dhe Kryetare e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave dhe pjesëmarrës ishin: Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, zj. Milena Harito, z. Francisco Tur Hartmann, përfaqësues i Bankës Qendrore Evropiane, zj. Pascale – Marie Brien përfaqësuese e Federatës Evropiane Bankare, z. Frederic Blanc, anëtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Societe Generale Albania dhe z. Periklis Drougkas, Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania.

Ministrja e Inovacionit dhe Administratës Publike, zj. Milena Harito gjatë fjalës së saj prezantoi zhvillimet më të fundit lidhur me projektet e ndërmarra në fushën e digjitalizimit të shërbimeve





qeveritare nga ana e qeverisë shqiptare.

Në panelin e dytë u paraqitën zhvillimet e fundit lidhur me transformimin digjital dhe rolin e tij në industrinë bankare. Ky panel, i moderuar nga zj. Maria Teresa Chiementi përfaqësuese e Grupit të Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave pranë Bankës Botërore, u fokusua në zhvillimet më të fundit në perspektivën e inovacionit nga aktorët e tregut. Vlerë të shtuar kishte dhe prezantimi i z. Wim Mijs, Drejtor Ekzekutiv i Federatës Evropiane Bankare, i cili foli mbi kuadrin rregullativ në Bashkimin Evropian dhe ndikimin në Shqipëri. Në këtë seksion, referuesit nga Turqia (Garanti Bank) dhe Polonia sollën eksperiencën e vendeve dhe respektivisht trendin e fundit në bankingun digjital dhe modelin e ndjekur nga Polonia në sistemet e pagesave.

Paneli i tretë me temë “Banka digjitale në Shqipëri - ku pozicionohemi dhe çfarë duhet të dimë” u drejtua nga Kryetari i Shoqatës së Bankave, z. Christian Canacaris dhe pjesëmarrës ishin z. Enkelejd Zotaj nga Raiffeisen Bank, z. Fatih Karli, BKT, z. Gideon Van Der Broek dhe z. Paul Wide nga International Commercial Bank. Referuesit prezantuan produkte dhe shërbime që ofrohen tek konsumatori shqiptar nga bankat që ata përfaqësojnë.

Gjatë dy prezantimeve të fundit nga z. Romano Stasi, Drejtor i Shoqatës Italiane të Bankave dhe z. Raja Said, përfaqësues i ProgressSoft Corporation, u trajtuan tema në lidhje me sigurinë e informacionit në kuadër të zhvillimeve të reja në teknologji dhe u prezantuan zgjidhje të mundshme në lidhje me sektorin e pagesave të cilat mund të aplikohen në të ardhmen në sektorin bankar.

Në konferencë ishin të ftuar gazetarë, organizatat ndërkombëtare, shoqëri të telekomunikacionit, ofrues të produkteve dhe shërbimeve inovative në sektorin bankar, si dhe grupe e interesit mbi teknologjinë.



Mbi ndryshimet më të fundit në Kodin e Punës

Takimi u organizua më 6 prill, në bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Inspektoratin e Punës, dhe shërbeu për të sqaruar ndryshimet e fundit në Kodin e Punës si dhe çështje konkrete ngritur nga bankat.



AAB organizon mbledhjen e 42-të të Anëtarëve të Asociuar të FEB (EBF)

Takimi i 42-të i anëtarëve të asociuar të Federatës Evropiane të Bankave (EBF) u zhvillua më datë 29 prill 2016, në Tiranë. Në takim morën pjesë përfaqësues të shoqatave kombëtare të bankave nga Shqipëria, Italia, Hungaria, Gjermania, Estonia, Republika Çeke, Azerbajxhan, Luksemburg, Mali i Zi, Polonia, Serbia dhe Turqia si dhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë.

Të ftuar dhe referues në këtë takim ishin dhe Z. Erjon Luci, zv/ministër, Ministria e Financave; Zj. Natasha AHMETAJ, Zëvendësguvernatore e Dytë e Bankës së Shqipërisë dhe Z. Christian CANACARIS, të cilët prezantuan ndryshimet ekonomike dhe sfidat e të ardhmes në Shqipëri si dhe zhvillimet në sektorin bankar.

Takimi shërbeu si një mundësi për të diskutuar mbi zhvillimet politike dhe rregullatore në BE; eksperiencat e anëtarëve në lidhje me sigurinë kibernetike, si dhe iniciativat e ndërmarra në kuadër të Edukimit Financiar (Javës Evropiane të Parasë), ku Shqipëria kishte një program të larmishëm aktivitetesh këtë vit.

Më datë 30 prill, nën kujdesin e Sekretariatit të AAB u organizua për të pranishmit një vizitë në qytetin e vjetër të Beratit, i cila është nën mbrojtjen e UNESCO-s dhe kombinon kulturën dhe traditat lindore dhe perëndimore.



Mbledhja e dytë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave (KKSP)

Në datën 24 maj 2016, në ambientet e Bankës së Shqipërisë, u zhvillua mbledhja e dytë e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave. AAB u përfaqësua në këtë mbledhje nga z. Frederic Blanc, anëtar i Bordit Ekzekutiv të AAB-së dhe CEO i Societe Generale Albania, zj. Najada Xhaxha, Kryetare e Komitetit të Pagesave në AAB dhe anëtare e KKSP, dhe Dr. Spiro Brumbullli, Sekretar i Përgjithshëm i AAB. Përveç çështjeve të tjera, në kuadër të standardizimit të urdhërpagesës, u prezantua formati i dakordësuar midis bankave, i cili bazohet në standardet e SEPA-s.



“Reforma në drejtësi - parakusht për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri”

Konferenca u organizua nga Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA), në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit Europian, më 23 maj 2016. Në fjalën e tij, z. Christian Canacaris, Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave, u shpreh se: “Reforma në Drejtësi duhet parë si një detyrim që secili nga ne ka për zhvillimin e vendit. Kjo reformë është një sfidë kyçe për të përshpejtuar anëtarësimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian.”



Forumi i Studenteve të Financës në UET - Eseja më e mirë

Departamenti i Financës në Universitetin Europian të Tiranës (UET) organizoi në 26 maj, forumin e përvitshëm të studentëve të këtij departamenti. Forumi i Studenteve të Financës në UET është i organizuar në formën e një konkursi, ku komisioni, përzgjedh 3 punimet më të mira dhe jep çmime. Këtë vit, fituesi i vendit të dytë i Forumit u nderua me një çmim nga AAB.



Forumi IV Financiar i Shqipërisë

Në datë 23 qershor 2016 zhvilloi punimet Forumi IV Financiar i Shqipërisë, organizuar nga Banka e Shqipërisë dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar. Këtë vit, diskutimet e këtij forumi u fokusuan në çështjen e rigjallërimit të kreditimit, në mbështetje të një rritjeje ekonomike të qëndrueshme. Në forum morën pjesë dhe drejtorë të përgjithshëm të bankave kryesore që operojnë në Shqipëri.

2016



Menaxhimi i rrezikut për specialistët e menaxhimit të rrezikut dhe auditit të brendshëm

Ky trajnim u organizua në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Auditorëve të Brendshëm (AIIA) më 20-21 prill 2016. Trajnimi u realizua nga dy trajnues, një ndërkombëtar dhe një vendas, si një mundësi për krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe për të kuptuar njëri-tjetrin më mirë, si dhe në drejtim të bashkëpunimit për përmirësimin e kulturës së rrezikut të organizatës së tyre. Trajnimi u ndoq nga 6 pjesëmarrës prej bankave anëtare.

Trajnimi i trajnuesve: Didaktika dhe Metodologjia

Ky trajnim u organizua më 25 - 27 maj 2016 në bashkëpunim me Institutin Austriak i Ekselencës dhe mbështetjen logjistike nga Banka Credins. Seminari u përqendrua në prirjet dhe teorinë më të fundit, lidhur me metodologjinë e bazuar në kompetenca dhe me qendër nxënësin dhe u ndoq nga 10 pjesëmarrës prej 7 bankave anëtare.



2016

2016



Takim – Diskutimi mbi rrezikun operacional dhe krimin financiar

Ky takim – diskutimi u organizua me mbështetjen financiare të IFC-së në 15 qershor 2016 në Tiranë. Në trajnim u trajtuan elementet kryesore lidhur me menaxhimin e rrezikut operacional dhe parandalimin e krimit financiar, duke gërshtuar leksionet me përmbledhjet e rasteve studimore. Seminari u ndoq nga 19 pjesëmarrës nga sistemi bankar.

Trajnim për shitjet & negocimin

Ky trajnim u organizua më 27 - 28 maj 2016, në bashkëpunim me Institutin Austriak të Ekselencës. Ai trajtoi teorinë trajnuese, sfiduese, intuitave dhe të drejtuara nga rezultati, lidhur me shitjet, si dhe ushtrime praktike. Trajnimi u zhvillua nga z. Eric Molin, ekspert i trajnimit për komunikimit dhe u ndoq nga 14 pjesëmarrës.



2016

